



Nisin me 10 janar 2022, aplikimet për grante nga IPARD II – zbardhet udhezimi

Faqe \$



Bujqësia, në “qieł të hapur” përballë përmbajtjeve-Rrapaj: E domosdoshme një skemë për pagesën e primit të sigurimit me tre aktorë

Faqe 4



Të rikthehesh në fshat - Të moshuarit që zgjedhin sërish jetën rurale pas shumë vitesh në qytet

Faqe 6



AGROBIZNESI

BOTIM I KËSHILLIT TË AGROBIZNESIT SHQIPTAR

Adresa: Rruga "Mine Peza", Pallati 87/3, Hyrja 1, Kati i parë, Tel/ Fax: 2229445
E-mail: infokash@yahoo.com www.kash.org.al



Rr. "Qemal Stafa", P. 9-katësh,
Nr. 70, Kati 2, Pazari i ri, Tiranë.
Tel: +355 4 2 251 910 /911
Email: info@fedinvest.al
kontakt@fedinvest.al
www.fedinvest.al

15-ditëshi i dytë i muajit dhjetor 2021

Viti i shtatëmbëdhjetë i botimit - Nr. 428
Çmimi 125 lekë

E përdryjavshme e pavarur

ILO, JICA, FED INVEST, KASH, MBZHR, FORUM MBI ÇËSHTJET QË SHQETËSOJNË BLEGTORINË REZOLUTË E FORUMIT “PËRMIRËSIM I TREGUESVE NË BLEGTORI”

Pedagogë të UBT, ekspertë të FED invest, fermerë, blegtorë, specialistë, përfaqësues të KASH diskutuan me krerët më të lartë të MBZHR mbi problemet e blegtorisë dhe zgjidhjet përkatëse për: uljen drastike të numrit të krerëve, mungesën e shërbimit zooteknik, nevojën për përdorimin e teknologjive të reja dhe platformave dixhitale si ABA online, bashkërendim me qendrat e formimit profesional, nevojën për subvencione si dhe organizimin e fermerëve në kooperativa për të mbrojtur çmimin e produkteve të qumështit e mishit etj.



- Marrëveshja e bashkëpunimit - Për herë të parë hapet eksporti për produktet blegtorale e kafshët e gjalla



Faqe 2

TAKIM I ISH-MINISTRAVE

Sfidat e sektorit të blegtorisë në fokus të takimit të Ministrave të Bujqësisë në vite



Faqe 2




Takim me agronomin shqiptaro-amerikan Koço Mosko

Përgatiti: Fatos Fico, Londër

Faqe 11

RISI ALBANIA

Një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC



MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT TË BUJQËSISË,
SIGURISË USHQIMORE DHE ZHVILLIMIT RURAL

Faqe 11, 12

KËNDI I EKSPERTIT

FED INVEST

Në rrugëtimin historik të FED invest

Faqe 2

MINISTRAT E BUJQËSISË NË VITE

Ministrat e bujqësisë në vite, pjesëmarrës në tryezën tematike për blegtorinë



Faqe 2

Sfidat e sektorit të blegtorisë në fokus të takimit të Ministrave të Bujqësisë në vite

KASH duke filluar nga muaji Dhjetor 2021 e në vijim ka programuar të organizojë disa Tryeza tematike me Ministrat të bujqësisë në vite dhe disa Forume me pjesëmarrje të disa kontributorëve e personaliteteve të spikatur në sektoret përkatës, me përfaqësues të shoqatave të Agrobiznesit, për të diskutuar dhe kontribuar me ide, propozime e sugjerime, për përmirësimin e situatës dhe zhvillimin e sektorëve kryesorë të fushës së Ekonomisë së Ushqimit në Shqipëri.

Sektorët kryesorë që janë përzgjedhur, për të diskutuar në Tryeza tematike dhe kontribuar në disa forume janë ato të: “Bujqësisë”, “Blegtorisë”, “Peshkimit dhe Akuakulturës”, “Agrobiznesit”, “Agropërpunimit”, “Bimëve aromatiko mjeksore dhe Bletarisë”, “Agroturizmit, Agropylltarisë dhe Mjedisit në zonat rurale”, Tregjeve Agro-Blegtorale”, “Financës dhe Mikrofinancës në Zonat Rurale”.

Tryeza e parë tematike u mbajt në dt. 11 dhjetor 2021 në ambientet e UKA FARM në Laknas, me objekt kryesor diskutimi Sektorin e Blegtorisë. Morën pjesë Ministrat e Bujqësisë në vite Deputeti Agron Duka, Prof. Edmond Panariti, Prof. Genc Ruli, Prof. Luftër Xhuveli, Prof. Rexhep Uka. Nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural Zv/Ministri Enio Civici. Gjithashtu pjesëmarrës ishin Ekspertë dhe

muar të zhvillojë në vijim, me përfaqësues të sektorit publik, me grupet e interesit, me fermerë, si dhe me donatorë të ndryshëm, që kanë objekt të tyre asistencën në fushën e Ekonomisë së Ushqimit. Fokusi kryesor i takimeve në vijim do të përqendrohet tek aktorët e subjektet që rezultojnë me prob-



leme dhe janë në vështirësi.

Produkti kryesor në përfundim të Tryezës së parë tematike ishte formulimi i një rezolute me ide, rekomandime, e masa që duhen marrë pa humbur më shumë kohë jo vetëm nga KASH, por edhe nga aktorët e tjerë të angazhuar në fushën e Ekonomisë së Ushqimit.

Tryeza e parë tematike për Blegtorinë nxiti dhe inkurajoi Këshillin e Agrobiznesit Shqiptar (KASH), që në bashkëpunim me Universitetin Bujqësor Tiranë (UBT), Universitetin Eqerem Çabej në Gjirokastrë, Universitetin Ismail Qemali në Vlorë,

- Blegtorë që mbarshojnë Gjerdhë, Bagëti të imta, Derra dhe Shpendë.

- Prodhues, grumbullues, transportues, përpunues të qumshtit, mishit, Lesh dele dhe dhie, Lëkurëve, Thertoreve,

- Tregjeve blegtorale, Transportuesve të kafshëve të gjalla.

- Ekspertë Zooteknike, Veterinerë, dhe Inxhinierë të nivelit të lartë.

- Drejtues dhe përfaqësues nga Shoqatat anëtare të KASH dhe Këshillave të Qarqeve të Shqipërisë.

- Drejtues dhe përfaqësues nga Agjensia Kombëtare dhe Agjensitë Rajonale të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Agjensia e Zhvillimit Bujqësor Rural, AZHBR.

- Përfaqësues nga Universiteti Bujqësor i Tiranës dhe Universiteti Eqerem Çabej në Gjirokastrë.

- Përfaqësues të disa donatorëve si: Organizata Ndërkombëtare e Punës, (ILO) Agjensia Japoneze për Kooperim Ndërkombëtar JICA dhe FED Invest SHKK.

- Drejtues e përfaqësues nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

KASH në Tryezat tematike dhe Forumet në vijim do të vazhdojë të kenë si objekt dhe do të fokusohet në dhënien e ideve, sugjerimeve dhe marrjen e disa masave, për të rikuperuar pasojat e tërmetit, pandemisë Covid-19, koniukturës së pafavorshme të rritjes së çmimeve të importit të mallrave, kushteve të pafavorshme të motit, si breshëri, ngricat, përmbytjet, zjarret etj. Gjithashtu në këto Forume u rekomandua të zhvillohen pranë subjekteve private dhe të demonstronhen disa mënyra e modele të reja dhe efçente, për të përmirësuar punën në Procesin e Kooperimit të Koordinimit, Fushën e Mekanizimit Inovacionit dhe Dixhitalizimit, Financimit dhe disbursimit e fondeve grant si dhe Përmirësimet e akteve ligjore e nënligjore, për t'i përafuar me ato të BE – duke patur synim kryesor shtimin e eksporteve, reduktimin e importeve dhe hapjen e eksporteve të kafshëve të gjalla si dhe shtimin e sasisë së produkteve vendase me origjinë shtazore.

Në rrugëtimin historik të FED invest

Data 4 dhjetor 2021 shënon një ditë të veçantë në historinë e FED invest, 6-vjetorin e krijimit të tij. Rruga e përshkuar për të arritur këtë stad zhvillimi nuk ishte e lehtë.

E filluara është që nga viti '92, kur mposhtën skepticismin dhe mentalitetin e zonave rurale për kredimarrjen; te disbursimi i kredive të para, ndonëse informale; përballimi me guxim i sprovës së fortë të vitit '97; formalizimi në dina-



ciare dhe jo-financiare; hapjen e qendrës ABA; lancimin e kanaleve të reja digjitale të shpërndarjes dhe komunikimit, etj. Përkthyer në shifra, sot, numri anëtarëve ka kaluar 80

ia Shqiptare dhe organizata ndërkombëtare financiare! Por aspiratat tona shkojnë përtej një institucioni të zakonshëm mikrofinancë. Sot FED invest është promotor dhe kampion i përfshirjes financiare dhe i zhvillimit të bujqësisë në Shqipëri. Ai sheh drejt së ardhmes me objektiva të qarta dhe ambicioze si: rritja në sektorin e SME-ve, krijimi i partnerëve të biznesit dhe financimi i zinxhirit të vlerës, promovimi dhe rritja e aktivitetit të pagesave utilitare, futja e produkteve të reja financiare si kredia 24h, overdrafti, kredia e dedikuar për agroturizimin, pagesat me kodin QR, etj.

Tashmë 2022-shi që vjen është një vit special për FED

Përkthyer në shifra, sot, numri anëtarëve ka kaluar 80-mijëshin, portofoli i kredisë dhe i depozitave po afrohet tek 4.8 miliardë Lekë, shërbimet e llogarisë rrjedhëse e pagesave utilitare dhe FED online janë shtrirë në të gjithë rrjetin, numri i degëve dhe i stafit është rritur dhe bashkë me to edhe qëndrueshmëria financiare e Institucionit.

mikë i strukturës së qeverisjes, përmirësimi i vazhdueshëm i kuadrit ligjor e rregullativ; për të kulmuar më 4 dhjetor 2015, me marrjen e një vendimi tjetër historik – themelimin e FED invest.

Gjithçka lindi nga bashkimi me përrithjeje i 69 SHKK-ve me ish SHKK Belsh. Zgjedhja e emrit nuk ishte rastësore: Bionomi FEDERATË + Investim që tregonte qëllimin e bashkimit në një federatë për investim, ose shkurt FED invest. Institucioni i ri mori bekimin (licencën) si SHKK Kombëtare në 2 mars 2016, nga Banka e Shqipërisë dhe më vonë edhe nga ASD.

Vërtetësia cilësohet ku hapi i parë ishte kryerja e një transformimi rrënjësor institucional dhe organizativ, duke vijuar me implementimin e sistemit të ri të teknologjisë, FlexCube dhe përmirësimin rrënjësor të infrastruktures fizike dhe digjitale; prezantimin e produkteve dhe shërbimeve të reja finan-

mijëshin, portofoli i kredisë dhe i depozitave po afrohet tek 4.8 miliardë Lekë, shërbimet e

Sot FED invest është promotor dhe kampion i përfshirjes financiare dhe i zhvillimit të bujqësisë në Shqipëri. Ai sheh drejt së ardhmes me objektiva të qarta dhe ambicioze si: rritja në sektorin e SME-ve, krijimi i partnerëve të biznesit dhe financimi i zinxhirit të vlerës, promovimi dhe rritja e aktivitetit të pagesave utilitare, futja e produkteve të reja financiare si kredia 24h, overdrafti, kredia e dedikuar për agroturizimin, pagesat me kodin QR, etj.

llogarisë rrjedhëse e pagesave utilitare dhe FED online janë shtrirë në të gjithë rrjetin, numri i degëve dhe i stafit është rritur dhe bashkë me to edhe qëndrueshmëria financiare e Institucionit.

Një udhëtim sa mbresëlënës, aq dhe frymëzues, i vlerësuar si histori suksesi nga Qever-

invest, që përkon me:30-vjetorin e fillimit të misionit të kësaj organizate, si një projekt i Bankës Botërore; po edhe 20 vjetorin e themelimit të Unionit SHKK (pararendësi i FED invest) si një arritje dhe risi unike e kohës. Pra, cilësohet se viti 2022 do të jetë një vit jubilar në të gjithë muajt e tij.

Marrëveshja e bashkëpunimit - Krifca: Për herë të parë hapet eksporti për produktet blegtorale e kafshët e gjalla

Në mbledhjen e sotme, kabineti qeveritar ka miratuar marrëveshjen e bashkëpunimit në fushën e veterinarisë, sigurisë ushqimore dhe fitosanitare, në kuadër të iniciativës së Ballkanit të Hapur, mes vendeve të Ballkanit Perëndimor.

Ministrja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Frida Krifca, në fjalën e mbajtur pas mbledhjes së qeverisë, tha se përfitimet e Shqipërisë në këtë marrëveshje do të mundesojnë që për herë të parë të hapet eksporti për të gjitha produktet blegtorale, duke përfshirë kafshët e gjalla në bazë të reciprocitetit, besueshmërinë nëpërmjet autoriteteve homologe të sigurisë ushqimore, si dhe duke respektuar mbrojtjen e territoreve

mes vendeve të përfshira në këtë marrëveshje nga sëmundjet e transmetueshme në bimë dhe në kafshë.

“Është një arritje pasi operatorët e biznesit e kanë adresuar prej disa kohësh.”, u shpreh Krifca.

Krifca tha se nëpërmjet kësaj marrëveshjeje do të njihen për herë të parë certifikatat e veterinarisë, ato shëndetësore dhe fitosanitare. Gjithashtu, Krifca tha se do të njihen në mënyrë reciproke tashmë edhe analizat nga laboratorët e autorizuar përveçse të akredituar për herë të parë, duke hequr një kosto të shtuar për biznesin, shkurtimin e kohës së qëndrimit në pikat kufitare dhe mos cënimin e cilësisë së produkteve për vendet

përfshirëse

“Sërish, duke adresuar një shqetësim që biznesi ka pasur dhe duke evituar ndalesat dhe kontrollet në pikat e inspektimit kufitar, duke kryer kontrolle tashmë në doganën më të afërt me vendet e destinacionit.”, u shpreh ministrja në fjalën e saj.

Krifca tha se përfitim i kësaj marrëveshjeje është që do të ulët koha e tranzitit në transportimin e mallrave.

Gjithashtu, ministrja komunikoi se marrëveshja nënkupton edhe shkëmbimin e informacioneve në kohë reale, ndërmjet autoriteteve kompetente, për të siguruar shkëmbimin e produkteve, me shume kontroll dhe mbarëvajtjen e tregtisë rajonale.



përfaqësues të KASH dhe shoqatave Anëtare që punojnë në Sektorin e Blegtorisë Z. Agim Rrapaj, Z. Edmond Gjata, Znj. Enida Shena, Prof. Anila Kopali, Dr. Valbona Ylli, Dr. Edi Fero, Dr. Sinan Sinani, Prof. Jani Mavromati, Dr. Kristaq Skënderi, Z. Argent Daci, Agr. Bedri Dima.

Diskutimet u përqendruan në: Masat që duhen marrë për të frenuar rënien e mëtejshme të treguesve në Sektorin e Blegtorisë në Shqipëri, si dhe në dhënien e disa ide e propozime për ringritjen e tyre”. Gjithashtu, Tryeza e parë tematike kontribuo dhe shërbeu, për të rritur efçencën e tryezave tematike dhe Forumeve, që KASH ka progra-

Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR), përfaqësues të pushtetit vendor dhe donatorët, që në situatën e krijuar të mblidhen e diskutojnë së bashku me të gjithë aktorët e interesuar në Tryeza tematike dhe Forume me moton: Ç’duhet të bëjmë më mirë aktualisht dhe në të ardhmen, për përmirësimin e situatës jo vetëm në Blegtori, por edhe për sektorët e tjerë të fushës së Ekonomisë së Ushqimit.

KASH duke vlerësuar rekomandimet në kuadër të konsolidimit të procesit të Kooperimit dhe Koordinimit u angazhua që në datën 23 dhjetor 2021 të organizojë një Forum dhe të ftojë për të diskutuar përfaqësues nga çdo hallkë e sektorit të blegtorisë dhe jo vetëm, si:

ILO, JICA, FED INVEST, KASH, MBZHR, FORUM MBI ÇËSHTJET QË SHQETËSOJNË BLEGTORINË

REZOLUTË E FORUMIT “PËRMIRËSIM I TREGUESVE NË BLEGTORI”

Pedagogë të UBT, ekspertë të FED invest, fermerë, blegtorë, specialistë, përfaqësues të KASH diskutuan me krerët më të lartë të MBZHR mbi problemet e blegtorisë dhe zgjidhjet përkatëse për: uljen drastike të numrit të krerëve, mungesën e shërbimit zooteknik, nevojën për përdorimin e teknologjive të reja dhe platformave dixhitale si ABA online, bashkërendim me qendrat e formimit profesional, nevojën për subvencione si dhe organizimin e fermerëve në kooperativa për të mbrojtur çmimin e produkteve të qumështit e mishit etj.

REZOLUTË E FORUMIT “PËRMIRËSIM I TREGUESVE NË BLEGTORI”

KASH, në përgjigje të shqetësimit në rritje të shoqatave anëtare, që punojnë në Sektorin e Blegtorisë dhe jo vetëm, për situatën e vështirë në të cilën ndodhet ky sektor, disa nga treguesit kryesorë të të cilit vijnë të përkeqësohen, mbasi organizoi **Tryezën tematike** për sektorin e Blegtorisë dt. 11.12.2021, ku mori edhe **mbështetjen e Ministrave të Bujqësisë në vite**, si dhe mirëkuptimin dhe kujdesin e veçantë të **Rektorit të Universiteti Bujqësor të Tiranës Prof. Fatbardh Sallaku dhe Ministres së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural Znj. Frida Krifca**, ndërmori nismën për organizimin e disa Tryezave tematike me pjesëmarrjen e disa aktorëve të rëndësishëm, për të diskutuar së bashku në një forum më të gjerë ide, iniciativa dhe masa që duhen marrë, me synimin afatshkurtër të ndërtimit pa humbur kohë të një “barrikade”, për frenimin e mëtejshëm të rënies dhe fillimin sa më shpejt të përmirësimit, përmes një rritje të qëndrueshme të treguesve në sektorin e Blegtorisë.

Në përfundim të diskutimeve Forumi për Blegtorinë arriti në konkluzion:

Kooperimi dhe Koordinimi i punës, për të mundësuar një bashkëveprim më të mirë midis hallkave në sektorin e blegtorisë, vlerësohet si një mundësi e mirë dhe një potencial i pasfrytëzuar si duhet deri tani, **për të reduktuar informalitetin dhe rritur eficientë**n në sektorin e Blegtorisë dhe jo vetëm.

Forumi për Blegtorinë nxit dhe inkurajon Këshillin e Agrobiznesit Shqiptar (KASH), Universitetin Bujqësor Tiranë (UBT), Universitetin “Eqerem Çabej” në Gjirokastrë, Universitetin “Is-mail Qemali” në Vlorë, Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR), përfaqësues të pushtetit vendor dhe donatorët, që në situatën e krijuar të mblidhen e diskutojnë së bashku me të gjithë aktorët e interesuar në Tryeza tematike dhe forume të tilla me moton: Ç’duhet të bëjmë më mirë aktualisht dhe në të ardhmen, për përmirësimin e situatës jo vetëm në Blegtori, por edhe për sektorët e tjerë të fushës së Ekonomisë së Ushqimit.

KASH duke vlerësuar procesin e Kooperimit dhe Koordinimit mundësoi pjesëmarrjen dhe bashkoi për të diskutuar në këtë forum përfaqësues nga çdo hallkë e sektorit, si:

- Blegtorë që mbarshojnë Gjedhë, Bagëti të imta, Derra dhe Shpendë.
- Prodhues, grumbullues, transportues, përpunues të qumështit, mishit, Lesh dele dhe dhie, Lëkurëve, Thertoreve,
- Tregjeve blegtorale, Transportuesve të kafshëve të gjalla.
- Ekspertë Zooteknie, Veterinerë, dhe Inxhinierë të nivelit të lartë.
- Drejtues dhe përfaqësues nga Shoqatat anëtare të KASH dhe Këshillave të Qarqeve të Shqipërisë.
- Drejtues dhe përfaqësues nga Agjencia Kombëtare dhe Agjensitë Rajonale të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Agjencia e Zhvillimit Bujqësor Rural, AZHBR.
- Përfaqësues nga Universiteti Bujqësor i Tiranës dhe Universiteti “Eqerem Çabej” në Gjirokastrë.
- Përfaqësues të disa donatorëve si: Organizata Ndërkombëtare e Punës, (ILO) Agjencia Japoneze për Kooperim Ndërkombëtar JICA dhe FED Invest SHKK.
- Drejtues e përfaqësues nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Pjesëmarrësit **vlerësuan** se Blegtoria për Shqipërinë është një sektor me potenciale të mëdha dhe me rëndësi të vecantë në fushën e Ekonomisë së Ushqimit. Gjithashtu, ajo është jetike për rolin dhe rëndësinë që ka për të ardhurat e rreth dyqind e nëntëdhjetë mijë fermerëve, për punësimin dhe sigurimin e ushqimit, për Turizmin rural, reduktimin e importit të produkteve ushqimore me origjinë shtazore, si dhe për zhvillimin e bujqësisë dhe zonave rurale në tërësi.

Lidhur me punën për frenimin e rënies së mëtejshme të treguesve në blegtori, si dhe masat që duhen marrë për rritjen e qëndrueshme të tyre, Forumi sugjeron:

Ngritjen dhe funksionimin e një Komiteti konsultativ ekspertësh, pranë Këshillit të Agrobiznesit Shqiptar KASH, me përfaqësues nga secili subjekt pjesëmarrës në Forumin e Blegtorisë datë 23 dhjetor 2021. Gjithashtu, pranë MBZHR sugjerohet ngritja dhe funksionimi i një **Këshilli konsultativ kombëtar për blegtorinë**.

Profesioni i zooteknikut duhet rivlerësuar e mbështetur me të gjitha mundësitë dhe mjetet që kemi në dispozicion, si një nevojë e domosdoshme për frenimin e rënies dhe ringritjen e treguesve në blegtori. Aktualisht, specialistët zooteknikë dhe studentët që studiojnë në degën e zooteknisë, përveçse një njësi numer të papërfillshëm, ndihen të nënvlerësuar. Forumi sugjeroi ngritjen e Institutit të Zooteknisë dhe amendimin e Ligjit për Shërbimin

Veterinar dhe funksionimin e Urdhërit të Mjekut Veterinar, për ta përafuar me direktivat e BE, ku të shtohen e përfshihen edhe disa nene, për të mbështetur financiarisht e forcuar paralelisht edhe profesionin e zooteknikut si atë të Mjekut Veteriner.

Vlerësimi i kapaciteteve të kullotave natyrale dhe nxjerrja e përmirësimi i akteve nënligjore që impaktojnë ato duhen realizuar nga ministritë përgjegjëse pa humbur kohë. Forma aktuale e decentralizuar e juridiksionit dhe administrimit të kullotave duhet të ndryshojë. Modeli nuk po funksionon. Pyjet, Kullotat dhe Ujërat janë nën Juridiksionin e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, Blegtoria nën juridiksionin e MBZHR, ndërsa administrimi i kullotave, i cili realizohet përmes kontratave njëvjeçare me blegtorët - është nën juridiksionin e Bashkive dhe Njësisve vendore, Kjo mënyrë administrimi e kullotave duhet ndryshuar.

Sektori i prodhimit dhe përpunimit të ushqimeve për blegtorinë duhet mbështetur me përparësi përmes një projekti pilot asistence teknike dhe financiare, për të futur në rrugën e zgjidhjes kapacitetet e pamjaftueshme të prodhimit dhe përpunimit të ushqimeve për blegtorinë, nivelin e ulët të mekanizimit, koston dhe çmimet e larta të tyre, si dhe konkurrencën e pandershme që ju bëhet prodhuesve vendas nga importuesit e ushqimeve për blegtorinë.

Censusi për Blegtorinë është një tjetër mjet efikas, që duhet përdorur më shpesh për të vlerësuar realisht situatën. Përdorimi masiv i këtyre instrumentave dhe platformave, si dhe përfshirja e FED INVEST, KASH, UBT dhe institucioneve të tjera të arsimit të lartë, për të mundësuar zbatimin me efikasitet dhe me sa më pak shpenzime të këtyre sistemeve elektronike, është një mundësi reale, e cila krijon kushte për marrjen e vendimeve të duhura, që mund të realizohen pa humbur shumë kohë në kushtet aktuale.

Shtimi i numrit të Projekteve pilot. Ato janë një mundësi e mirë për ndërtimin e modeleve bashkëkohore, që t’i shërbejnë jo vetëm sektorit të blegtorisë, por edhe Turizmit rural dhe përmirësimit të mjedisit në zonat rurale, për të realizuar në një periudhë sa më të shkurtër objektivat e miratuara. Projekte të tilla pilot mund të realizohen si fillim në bashkëpunim me Shoqëritë e Bashkëpunimit të regjistruara në QKB, përmes nënshkrimit të kontratave kolektive, duke i mbështetur këto subjekte financiarisht me grante, për përdorimin e teknologjive bashkëkohore të përpunimit të mbetjeve blegtorale, si dhe mbetjeve të tjera organike, që dekompozohen në natyrë dhe ndotin mjedisin; për prodhimin e plehut organik të pastër; për mbështetje me mjete të specializuara për transportin e kafshëve të gjalla; mbështetje fillimisht për ndërtimin dhe funksionimin e disa tregjeve model, për grumbullimin dhe shitjen e kafshëve të gjalla, si në tregun vendas dhe në eksport etj.

Mekanizimi, Inovacioni dhe Dixhitalizimi në Blegtori janë instrumente eficientë dhe ruga e duhur për të ulur koston, rritur rendimentin dhe përballuar mungesën e fuqisë punëtore në sektorin e blegtorisë dhe jo vetëm.

Sistemi i informacionit elektronik për Identifikim Regjistrimin në Blegtori (RUDA) duhet të bëhet i aksesueshëm dhe eficient. Gjithashtu edhe **Platforma elektronike ABA Online** duhet aplikuar në të gjithë sektorët e Ekonomisë së Ushqimit.

Përdorimi masivisht i instrumenteve të tjerë të kontrollit dixhital në distancë, janë shumë të rëndësishëm për të përmirësuar situatën në sektorin e blegtorisë dhe jo vetëm.

Rishikimi i Paketës Fiskale, për kapitujt që impaktojnë Blegtorinë dhe sektorët kryesorë të Ekonomisë së Ushqimit; si dhe **Projekt buxheti afat mesëm 2021 - 2024 të MBZHR, dhe Strategjia sektoriale e zhvillimit rural për periudhën 2021 – 2027**, e cila aktualisht është një draft dhe në proces për marrje mendimesh dhe konsultimi me grupet e interesit. Realisht, tani është koha për të kontribuar me disa ide dobiprurëse e propozime konkrete, të mirëargumentuara, që të mund të reflektohen dhe ndikojnë pozitivisht edhe në ndryshimet e mundshme të Paketës Fiskale dhe në Buxhetin afatmesëm të MBZHR. Gjithashtu, të mundësohet miratimi i një Strategjie të mirëkonsultuar, dobiprurëse dhe të pranueshme edhe për sektorin privat të blegtorisë dhe jo vetëm. Objektivat që do të shkruhen në strategji, si dhe masat afatshkurtëra, afatmesme dhe afatgjata që do të miratohen, duhet të ballafaqohen me situatën aktuale të blegtorisë: Situata e veçantë që është krijuar mbas pasojave që la tërmeti i 26 nëntorit 2019, pandemia Covid - 19, koniuktura e rritjes së çmimeve nga importi nga viti 2020 e në vijim, kushtet të larta të favorshme të motit. Puna duhet filluar me urgjencë për të saktësuar e ndjekur në dinamikën e vet, përmes sistemit Elektronik RUDA dhe sistemeve të tjera, inventarin dhe remontin në blegtori.

Problemet e financimit me kushte lehtësuese dhe uljes

së koston për sektorin e blegtorisë në tërësi dhe prodhimin e ushqimeve të blegtorisë në veçanti i duhet kushtuar vëmendja e posaçme për t’u dhënë zgjidhje në këtë situatë. Subjekteve blegtorale në vështirësi likuiditeti u duhet dhënë një ndihmë konkrete për hartimin e plan-bizneseve, për vitin 2022 e në vijim, duke u treguar rrugët e mundshme për të zgjidhur problemet që kanë me shlyerjen e kredive të marra në institucionet financiare. Arsyet objektive si termeti, pandemia, konjuktura ndërkombëtare e rritjes së çmimeve të importit, ndalimi i eksportit, kushtet e vështira të motit, vështirësitë për të siguruar blegtorinë në shoqëritë e sigurimit, janë disa nga argumentat e arsyeshme, për të ndërmarrë disa iniciativa në këtë situatë, për reduktimin e borxheve, të % së interesave, zgjatjen e afatit të shlyerjes së kredive, deri edhe bllokimin e proceseve përbarimore për një periudhë të limituar kohe.

Forum i vlerëson se në kushtet që jemi, më lehtë është të intensifikohet puna që të realizohen sa më shpejt masat për reduktimin e produkteve blegtorale të importit për nevojat të tregut vendas, se sa të stimulohen ato për eksportin e tyre.

Skema kombëtare e mbështetjes me subvencione nga buxheti i shtetit për blegtorinë duhet të përmirësohet. Ajo për një periudhë kohe të limituar duhet të mbështesë pa kufizim investimet në kullota dhe blegtorët e paformalizuar që të formalizohen, të cilët duhet të nënshkruajnë kontrata me subjekte dhe institucionet përgjegjëse për dorëzimin e tepricave të prodhimit. Mbështetja duhet të zgjasë deri në stabilizimin e treguesve të prodhimit blegtoral të parashikuar në strategji.

Subvencionimi duhet bërë për numër krerësh në tërësi. Ai duhet diferencuar në rritje për kontigjentin e bagëtive që mbahen për remont, por duhet zgjeruar edhe kur dorëzohen bagëtitë në thertore në pesha optimale, si dhe duhet aplikuar për njësi prodhimi të qumështit, mishit dhe lëkurëve. Efienca e investimeve përmes pjesëmarrjes me subvencione dhe shfrytëzimi i kapaciteteve të përpunimit të qumështit në vend duhet ristudjuar. Kapacitetet aktuale përpunuese të qumështit tejkalojnë ndjeshëm kapacitetet prodhuese dhe nevojat e tregut vendas.

Sektori i Medikamenteve veterinarë dhe insiminimit artificial janë shumë të rëndësishme dhe duhet treguar një kujdes i shtuar për kontrollin e tyre në pikat kufitare, për të ndaluar kontrabandën dhe shtuar masat për përdorimin e tyre me kriter. Këto masa të shoqërohen me fuqizimin e laboratorëve të akredituar dhe specializuar për shëndetin e kafshëve.

Tregjeve të shitjes së kafshëve të gjalla duhet t’u jepet prioritet pa humbur kohë duke mundësuar e mbështetur përmes projekteve pilot minimalisht 4 tregje model, që të plotësojnë të gjitha kriteret dhe standardet e kërkuara, të cilët të jenë në funksion të plotësisht të nevojave të tregut vendas dhe atë të kërkesave për eksport në vendet e rajonit dhe më gjerë.

Nënshkrimi i marrëveshjeve në kuadër të nismës Ballkani Hapur, të cilat do të lehtësojnë procedurat burokratike dhe do të kursejnë kohë në pikat doganore do të bëjnë të mundur eksportin e prodhimeve me origjinë shtazore dhe atë të kafshëve të gjalla në veçanti në vendet e rajonit. Nisma vlerësohet me interes dhe konsiderohet mjaft dobiprurëse, veçanërisht për blegtorët që mbarshojnë bagëti të imta, duke i ndihmuar dhe lehtësuar shumë për gjetjen e tregjeve në periudhën e shkëputjes nga mëmat të qëngjave dhe kecape.

Gazeta “Agrobiznesi” organ i KASH do të hapë rubrikën e re për blegtorinë dhe do të ndjekë në vijimësi realizimin e sugjerimeve të bëra në Tryezën Tematike për Situatën në Blegtori të ministrave të Bujqësisë në vite, të datës 11 dhjetor 2021, si dhe konkluzionet e arritura në Rezolutën e Forumit për Blegtorinë datë 23 dhjetor 2021.

Pjesëmarrësit në Forumin për Blegtorinë duke vlerësuar dobinë e saj, **falenderuan për mbështetjen** Organizatën Ndërkombëtare të Punës (ILO), Agjensinë Japoneze për Kooperim Ndërkombëtar JICA dhe FED Invest SHKK. Gjithashtu, nxitën dhe inkurajuan iniciativën e KASH si organizator dhe sugjeruan që **KASH të vijojë punën për organizimin e Tryezave tematike dhe Forumeve**, për të diskutuar me radhë deri në muajin qershor 2022 edhe për sektorët e tjerë të fushës së Ekonomisë së Ushqimit. Gjithashtu, në përfundim të Tryezave tematike dhe Forumeve për secilin sektor u sugjerua të organizohet edhe një Konferencë Kombëtare për Përmirësimin e treguesve në fushën e Ekonomisë së Ushqimit në Shqipëri.

Në përfundim, Forumi miratoi edhe propozimin për ngritjen e Komitetit Konsultativ të Ekspertëve të Blegtorisë pranë KASH.

Forum i për Përmirësimin e Treguesve në Blegtori Këshilli Agrobiznesit Shqiptar, KASH

FINANCIM

Bujqësia, në “qiell të hapur” përballë përmbytjeve, Rrapaj: E domosdoshme një skemë për pagesën e primit të sigurimit me tre aktorë

Ndërkohë që fermerët dhe subjektet agroushqimore po përballen me përmbytjet e para të sezonit, sektori bujqësor është në “qiell të hapur” sa i takon sigurimit dhe pret kompensim vetëm nga buxheti i shtetit.

Në një intervistë për SCAN, Kreu i Agrobiznesit Shqiptar, Agim Rrapaj thekson se kjo ndodh për shkak se fermerët dhe agrobizneset e kanë të pamundur ta përballojnë të vetëm primin e sigurimit.

Për të zgjidhur këtë situatë, Rrapaj propozon një skemë për pagesën e primit të sigurimit ku të përfshihen tre aktorë, buxheti i shtetit fermeri dhe një institucion financiar si donatore, në mënyrë që kostot të jenë më të ulëta.

Pak kohë më parë edhe kryeministri Edi Rama theksoi se po punohet për një skemë sigurimi në fushën e bujqësisë, ku fermerët të kenë kosto të ulëta.

Të paktën 1000 hektarë tokë bujqësore nga të cilat 25 hektarë sera janë përmbytur gjatë reshjeve të fundit nga

dalja e lumenjve nga shtrati në Jug të vendit, deklaroi MB-ZHR. Dëmet më të mëdha u krijuan në njësinë administrative të Kutallisë në Berat një nga zonat më prodhuese në vend me bujqësi intensive.

Gentian Ziu një fermer aktiv në zonë, i cili prej vitesh kultivon mbi 1 hektarë serë tha se pas humbjeve të mëdha që përjetuan fermerët nga mbjelljet e dyta, reshjet erdhën si mallkim. Ujërat që kanë vërshuar në tokat arë dhe në sera dëmtuan rëndë të mbjellat që gjetën, por ndërkohë e kanë bërë tokën të papunueshme për së paku deri në mars. Llumi që lanë përmbytjet e dëmton rëndë tokën. Shpesh ato sjellin materiale dhe lëndë ndotëse, por më e keqja është se tani fermerët që kishin sera nuk mund të mbjellin.

“Tani është sezoni i mb-

jelljes për prodhimin e pranverës ose siç quhen ndryshe nga fermerët janë mbjelljet e para. Ky është sezoni që siguron edhe fitimet më të larta

me humbje të larta për dy sezone rresht” tha fermeri Gentian Ziu nga Kutallia e Beratit.

Përveç dëmeve në sera përmbytjet dëmtuan dhjetëra



për fermerët. Tani që serat u përmbytën mbjellja mund të vonohet deri në pranverë. Kështu fermerët po përballen

hektarë tokë në me grurë të mbjella në fushë, të cilat po kalben poshtë ujit dhe llumit që krijoi përmbytja.

Nisin aplikimet për grante nga IPARD II

Bashkimi Evropian Instrumenti për Ndhimën Para Anëtarësimit Për Zhvillimin Rural – IPARD II

THIRRJA E KATËRT PËR APLIKIME Nr. 04/2022 Nga Programi IPARD II

Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural e Shqipërisë njofton Thirrjen e Katërt për dorëzimin e aplikimeve në kuadër të Programit IPARD II nga Instrumenti i Ndhimës së Para-Anëtarësimit (IPA) për Zhvillimin Rural (IPARD) me qëllim të zhvillimit të Sektorit Agro - Ushqimor.

Thirrja e katërt për aplikime është e hapur për të gjithë personat (persona fizikë dhe juridikë), puna dhe veprimtaria e të cilëve zhvillohet brenda territorit të Republikës së Shqipërisë në fushat e prodhimit bujqësor /ose të agro-përpunimit dhe rural në masën e mëposhtme:

Masa 7: “Diversifikimi i fermave dhe zhvillimi i biznesit” me fokus të veçantë në sektorët e mëposhtëm:

- Turizmi rural dhe i Natyrës;
- Punimet e artizanatit dhe industria e manufakturës;
- Prodhimi i energjisë së rinovueshme.

Objektivat e masave të Programit IPARD II të përzgjedhura janë në përputhje me objektivat e

Dokumentit Strategjik Kombëtar (DSK) dhe kontribuojnë për:

• Mbështetjen e investimeve në sektorin agro-ushqimor me qëllim përmirësimin e konkurrencës, pajtueshmërinë me standardet e BE-së dhe ruajtjen e natyrës dhe mjedisit;

• Mbështetjen e investimeve në zonat rurale me qëllim diversifikimin e ekonomisë rurale dhe krijimin e biznesit, duke çuar në përmirësimin e mundësive të punësimit dhe përfshirjes sociale.

Përfutuesi i grantit është një person fizik ose juridik që përfiton mbështetje financiare nga IPARD II. Aktivitetet e investimeve (projekti): përbëhet nga një sërë veprimtarish për investime në asetet e luajtshme dhe të paluajtshme, duke synuar objektivat e sektorëve të mbështetur, të specifikuar në masën 7. Shpenzimet e përgjithshme përfaqësojnë një shpenzim të referuar për inxhinierët dhe tarifën e tjera të konsultimit, studimet e fizibilitetit, fitimin e të drejtave të patentës ose licencave.

Buxheti i përgjithshëm në dispozicion të kësaj thirrje është 4.1 milion EURO nga të cilat 75% ose 3.075 Milion EURO kontribut i BE dhe 25% ose 1.025 Milion EURO kontribut i buxhetit të shtetit.

*Ky buxhet mund të rritet në varësi të vendim-marrjes së institucioneve zbatuese të Programit IPARD II dhe disponueshmërisë së fondeve të dedikuara për Masën 7.

Masa 7: me buxhet total 4.1 milion EURO.

Nën Masën 7 totali i shpenzimeve të pranueshme për ndihmen e kërkuar do të jetë në kufijtë minimal dhe maksimal si:

• Shuma minimale e totalit të shpenzimeve të pranueshme: 10,000 EURO;

• Shuma maksimale e totalit të shpenzimeve të pranueshme: 400,000 EURO;

Një aplikant mund të përfitojë më shumë se një projekt in-

vestimi, por totali i kostove të pranueshme të investimeve për aplikant, për këtë masë nuk duhet ta kalojë vlerën prej 600,000 Euro për të gjithë kohë zgjatjen e periudhës së programit. Përqindja e mbështetjes publike është e barabartë me:

- 65% të totalit të kostove të pranueshme të investimit;

Kriteret e pranueshmërisë të aplikueshme për të gjitha masat janë:

I. ndërtimi apo përmirësimi i pasurive të paluajtshme, deri në masën e vlerës së tregut të pasurisë;

II. blerja e makinerive dhe pajisjeve të reja, përfshirë programe kompjuterike, deri në masën e vlerës së tregut të pasurisë;

III. kostot e përgjithshme që lidhen me shpenzimet e investimit (i) dhe (ii), si p.sh. tarifën e konsulencës të tilla si ato për arkitektë, inxhinierë etj, studime fizibiliteti, përgatitja e planit të biznesit, do të jenë të pranueshme për tu rimbursuar deri në një tavan prej 12% të kostove të përcaktuara në pikat (i) dhe (ii). Maksimumi i shpenzimeve për përgatitjen e planit të biznesit duhet të jetë 4% i kostove të përmendura në pikat (i) dhe (ii) pa e kaluar vlerën e barabartë me 5,000 Euro.

IV. Kostot e përgjithshme konsiderohen të pranueshme nëse projekti të cilit i përkasin është përzgjedhur dhe është kontraktuar prej AZHBR. Aplikanti duhet të provojë pronësinë mbi tokën/ndërtesën ose ndërtesat të lidhura me investimin ose të drejtën e përdorimit me afat të paktën 10 vjet që nga data e dorëzimit të aplikimit. Janë të pranueshme vetëm shpenzimet e bëra pas firmosjes së kontratës së grantit ndërmjet marrësit të mbështetjes dhe AZHBR (me përjashtim të kostove të përgjithshme për shpenzimet e investimit përkatës).

V. Projektet e investimeve mbeten të pranueshme për tu financuar nga BE-ja në të ardhmen, me kusht që të mos i nënshtrohen modifikimeve thelbësore brenda pesë vitesh nga pagesa e fundit e AZHBR.

KUJDES: Në Thirrjen IV, për masën 7 do të mbështeten vetëm sektorët:

- Turizmi rural dhe i Natyrës;
- Punimet e artizanatit dhe industria e manufakturës;
- Prodhimi i energjisë së rinovueshme.

Sektorët e tjerë të masës 7, nuk do të mbështeten në këtë thirrje.

Të gjitha palët e interesuara janë të lutura të marrin informacionin e duhur lidhur me llojet e investimeve të pranueshme, aplikantët e pranueshëm, kriteret e përzgjedhjes dhe rregullat e dorëzimit të aplikimeve në Udhëzuesin për Aplikantët, i cili mund të kërkohet si kopje e printuar në zyrat e Autoritetit Menaxhues pranë Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (AZHBR), gjatë orarit zyrtar nga e Hëna në të Enjte 08:00-16:30 dhe ditën e Premte 08:00 – 14:00.

të dyta dhe mungesa e subvencioneve.

Historikisht bizneset bujqësore, sidomos fermat prodhuese, kanë vuajtur nga norma të ulëta të fitimit, por së fundmi rritja e kostove të lëndëve të para dhe mungesa e tregut po lë pa mbjellë qindra hektarë tokë për sezonin tjetër. Në zonat e Fierit dhe Lushnjës këtë vit, ureja shitet 120% më shtrenjtë dhe nitratit gati 250% më shumë se vitin e kaluar.

Gjithashtu janë rritur kostot për të gjitha helmet dhe pesticidet e tjera, plastmasën dhe hekurin e serrave. Fermeri Ziu tha se kosto e prodhimit të një kilogrami domate tani ka aritur në 330-350 lekë, në varësi të kulturës dhe farës, nga rreth 290 lekë ose 30 lekë vitin e kaluar. Ndërkohë çmimet e shitjes kanë rënë ndjeshëm poshtë koston.

Plehrat kimike dhe pesticidet, përveçse tregtohen me çmime shumë të larta për buxhetin e fermerëve, nuk janë as cilësore.

Gjithashtu, “Udhëzuesi për Aplikantët” dhe formatet zyrtare të dokumentave që duhet të përdoren (formulari i aplikimit standard, plani i biznesit standard), të Thirrjes së IV, mund të shkarkohen në versionin zyrtar nga data 10 dhjetor 2021, në faqen e internetit:

www.azhbr.gov.al , www.ipard.gov.al dhe www.bujqesia.gov.al.

Dorëzimi i aplikimeve fillon nga data 10 Janar 2022 deri në datën 25 Shkurt 2022. Afati i fundit i pranimit të aplikimeve do të jetë data 25 Shkurt 2022, ora 16:30

Të gjitha aplikimet duhet të dorëzohen vetëm në zyrat qendrore të AZHBR-së në zarfe të mbyllura me titullin “Thirrje për Dorëzimin e Aplikimeve,” së bashku me titullin e masës, emrin e plotë dhe adresën e aplikantit dhe me shënimin “Të mos hapet përpara dorëzimit”.

Aplikimet duhet të dorëzohen si më poshtë:

- Nëpërmjet dërgesës postare rekomande, ose
- Dorazi (duke përfshirë shërbimet korriere) direkt në Autoritetin Kontraktues në këmbim të një mandati dorëzimi me firmë dhe datë nga:

<Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural
Rruga “Muhamet Gjollësja”, Nr.56
Tiranë, Shqipëri>

Aplikimet e dërguara nëpërmjet çdo mënyre tjetër (p.sh. me faks apo e-mail) apo të dërguara në adresa të tjera do të refuzohen.

Çdo aplikim i mbërritur në AZHBR pas datës 25 Shkurt 2022 do të refuzohet.

Të gjitha afatet e mësipërme do të përlogariten duke u bazuar në Kodin e Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë.

Autoriteti Kontraktues do të ketë pronësinë e të gjitha aplikimeve që do të dorëzohen. Si pasojë, aplikantët nuk do të kenë të drejtë t'i marrin mbrapsht aplikimet e tyre.

Shënim për aplikantët potencialë:

Përdorimi i formateve të tjera përveç atyre të thirrjes 4 të publikuara në faqen e internetit:

www.azhbr.gov.al , është kusht skualifikues.

Aplikimet e dërguara në mënyra ose në adresa të tjera nuk do të pranohen.

Aplikimet e dorëzuara apo të marra pas përfundimit të afatit përfundimtar do të skualifikohen automatikisht.

Aplikimet e dorëzuara pa formatin e kërkuar të Formularit të Aplikimit do të skualifikohen automatikisht.

Aplikimet e dorëzuara pa formatin e kërkuar të Planit të Biznesit do të skualifikohen automatikisht.

TEMA TË DITËS

Përmbytjet, Rrapaj: Tokat nuk rikthehen në aktivitet prodhues për këtë sezon dhe fermerët detyrohen të largohen

Për kryetarin e Këshillit të Agrobiznesit Shqiptar, Agim Rrapaj, shqetësimi kryesor nga përmbytjet e ditëve të fundit, është që këto toka nuk rikthehen më në aktivitet prodhues për këtë vit dhe shumica e prodhuesve detyrohen të largohen nga vendi, pasi ndodhen në vështirësi për shkak të kredive apo borxheve. Në studion e A2 Business, ku ishin të pranishëm edhe kreui i Emergjencave Civile Haki Çako, Avni Ponari, drejtues i Sigal Uniqa Group Austria, ekspertët Uran Derri dhe Ilir Pilku, Rrapaj tha se, këta fermerë e shohin veten të pambështetur nga qeveria dhe kompensimi nuk e përballon dot dëmin e shkaktuar.

“Kjo nuk është hera e parë që ndodh por ata janë të shqetësuar për atë që i pret më mbrapa se shumica e tokave të tyre nuk rikthehen më në aktivitet prodhues në këtë sezon..

Ne nuk po i parandalojmë dot pasojat. Familjet që pësojnë këto dëme kanë kredi apo borxhe në këto momente ndodhen në vështirësi dhe një pjesë e tyre largohen nga vendi për emigracion dhe ky ka qenë shqetësimi ynë kryesor. E dyta te demtuarit e e shohin veten të pambështetur dhe masa e kompensimit është e tillë që nuk e përballon dëmin as në kohë dhe as në masën e duhur. Buxheti për kompensim ose nuk do jepet në kohën e duhur, ose nuk do të jepet fare. Aty ku kalon përmbytja dhe rikthimi në normalitet dhe prodhimi i keti sezoni është i humbur për ta. Me atë buxhet dhe infrastrukturë e pamjaftueshme në ujti dhe mbrojtjen nga përmbytja do të presim goditje më të mëdha”.

Sipas Rrapajt kompensimi nuk është zgjidhja me e mire, por duhen investime paraprake në buxhet dhe infrastrukturë. Ai thotë se duhet të rikthehen në punë specialistët e institutit të dikurshëm që merrej me këtë fenomen.

“Dëmet nuk janë vetëm nga lumenjtë, dëmi në bagëti e toka e fermerëve është më i madh nga perrenjtë dhe deget e lumenjve kryesore, pasi keto deme nuk janë as pjese e kompensimit. Praktika ka treguar se kompensimi nuk është zgjidhja me e mire. Parandalimi përmes investimeve paraprake është zgjidhja me e mire. Ka patur një institut me specialistë që është marrë me këtë problem. Është e domosdoshme t'i kthehemi praktikës së dikurshme dhe ata njerëz duhet aktivizuar se kapriçot e motit do të përkeqësohen”.

Ai i kërkoi kreut të Emergjencave Civile që para se të miratohet strategjia për mbrojtjen civile, të përfshihen në një kapitull edhe për përmbytjet dhe pasojat nga kushtet atmosferike.

Derri: Përmbytjet në zonat prodhuese do të ndikojnë në çmimet e fundvitit

Përmbytjet në zonat me prodhues të vendit do të ndikojnë drejtpërdrejt edhe në

rritjen e çmimeve të fundvitit. Këtë argumentim dha Uran Derri, sipas të cilit kulturat e prekura në ato zona nuk mund të rigjenerohen këtë vit.

“Pjesa e Kutallisë është zona më prodhuese e Shqipërisë, për kulturat e prekura në atë zonë është e pamundur që të rigjenerohet këtë vit dhe kjo do të ndikojë drejtpërdrejt në çmimet e fundvitit. Është e pashmangshme kjo”.

Ai përmend problemet me pasigurinë e fermerëve dhe mungesën e digave mbrojtëse në bujqësi, e cila sipas tij nuk mund të mbijetojë vetëm me

Niveli i ulët i sigurimit të aktiviteteve bujqësore, Ponari rendit arsytet dhe tregon mundësitë

Shqipëria ka nivelin më të ulët të sigurimit bujqësor dhe për këtë Avni Ponari, drejtues i Sigal Uniqa Group Austria, deklaroi se kjo ka disa arsye, por themelore është kultura e ulët e shqiptarëve.

“Nuk është thjesht produkti bujqësor, por në këtë nivel është e gjithë ekonomia shqiptare 35-40 euro për frymë në vit, kur rajoni ka mbi 100 dhe në vendet europiane ka

konsoliduar dhe ofron të gjitha llojet e mbulimeve për bujqësinë. Ka mundësi që fermerët të kenë mundësi për të mbijetuar dhe mos u rrezikuar nga fatkeqësitë natyrore. Duke marrë pjesë të gjithë, blejnë në tregje ndërkombëtare risigurime aq sa është vlera apo rreziku i mundshëm në Shqipëri. Përcaktohet primi vjetor dhe tarifa specifike për të blerë në tregjet ndërkombëtare. Vetë shteti mund të blejë rreziqe katastrofike në tregjet ndërkombëtare. Tregjet e sigurimeve mbulojnë jo vetëm rreziqet katastrofike që janë të përcaktuara, por

donator.

“Është problem ekonomik, për shumë ferma tonat, se nuk fitojnë asgjë, se shumica janë me humbje gjatë gjithë kohës. Por jam dakord që është çështje mentaliteti, por nëse formalizohemi mund të përballojmë një pjesë të primit. Një 18 % janë të siguruar dhe ky nuk mund ta përballojë i vetëm primin. E dyta ka të bëjë me kombinim dhe praktikën e mira. Aktori i parë është fermeri, i dyti shteti dhe i treti donatori. Nëse këta aktorë bashkohen do të krijojnë një strategji, por nëse nuk bëjmë një ligj për siguracionin

Kafaraj, zona më e prekur nga përmbytjet, Pilku: 300-400 mijë euro dëm kultivuesve të luleshtrydheve

Zona më e prekur nga përmbytjet e dhjetorit të këtij viti është ajo e Kafarajt në Qarkun e Fierit, si edhe ajo e Kutallisë dhe Goriçanit. Kjo u deklarua nga eksperti i Ekonomisë Ilir Pilku, sipas të cilit një kultivuesi luleshtrydhes i është dëmtuar 50% e prodhimit duke i shkaktuar 300-400 mijë euro dëm vetëm prodhim, pa llogaritur kostot e tjera. Ai tha se humbje të mëdha ka edhe në serra që kultivohen perime.

“Zona më e prekur është e Kafarajt ku janë 120 ha me luleshtrydhe, janë serra në formë tunelesh me luleshtrydhe, ku fatmirësisht rreth 30-40% e këtyre serrave është me luleshtrydhe që kultivohet me parë dhe tani ka sezonin e vjeljes. Afërsisht për një kultivar ka një dëmtim 50% të prodhimit dhe përlllogaritja që unë bëj është 300-400 mijë euro vetëm prodhim. Dëmi të tjera janë plastmasi i serrave. Përpos serrave normale që kultivojnë perime në Kutalli e Goriçan janë 30 ha në dy grupe; një grup që ishte në vjeljet e fundit të produktit, për festa. Ka humbje për serrat që kanë mbjellë prodhimin për marsin dhe prillin. Janë 30 ha të përmbytura”.

Për këtë situatë Pilku e vë gishtin te mos funksionimi i institucioneve dhe mungesa e një plani për menaxhimin e fatkeqësive, pasi sipas tij kompensimi nuk është zgjidhje për të menaxhuar riskun.

“Ne nuk kemi harmonizim të mirë të institucioneve dhe buxhete që i përket Ministrisë së Bujqësisë dhe institucioneve vartëse të saj, pushtetit lokal e bashkive në kërkesën e llogarisë në kolaudimin e veprave publike. Kanalet kulluese e hidrovores që në '96 nuk është vënë më dorë, riparime të pjesshme. Nuk kemi master plan për menaxhimin e fatkeqësive natyrore ku dhe si do bëhen ndërhyrjet”.

Pilkuthekson që nëse Ministria e Bujqësisë do të kishte një buxhet më të mirë për planin e ujitjes dhe kullimit sot do të kishim rreth 130 ha tokë më shumë në kanale kulluese e vaditëse.

“Buxheti i Ministrisë së Bujqësisë është 2.2 % më pak se vitin e kaluar. Nëse do të kishim një buxhetim të mirë dhe plan ujitje e kullim do të kishim sot rreth 130 ha tokë më shumë në kanale kulluese e vaditëse, do të kishim një përfshirje me të mirë të ujit. Kemi sot një klimë jo të mirë për fermerët. Kompensimi nuk është instrument primar, por veprat që funksionojnë për të menaxhuar riskun”.

Katastrofat natyrore, Çako: Strategji për zvogëlimin e riskut, janë identifikuar zonat

Shqipëria renditet ndër vendet e para në Europë që preket nga

Përmbytjet, Rrapaj: Tokat nuk rikthehen në aktivitet prodhues dhe fermerët largohen



ndihmat e shtetit, ndërsa përjashton emergjencat civile si shpëtuese të saj.

“95% e fermerëve janë të pasiguruar. Sado ndihma që jep shteti, dihet që nuk mbijeton dot. Nuk është detyrë e emergjencave civile të shpëtojë biznesin. Nga vetë raportet e qeverisë flitet për 650 diga mbrojtëse për bujqësinë. Një pjesë e madhe e tyre janë ndërtaur para 50 viteve dhe u ka skaduar afati ra 25 viteve”.

Duke qenë se Shqipëria është një ndër vendet më të prekura nga përmbytjet, Derri thekson se duhet të merren masa menaxhimin e mbrojtjes në bazë të direktivave të BE-së. Sipas tij kjo duhet të ishte përmbushur që në 2014, por është shtyrë për në 2023.

“Raporti i BB dhe institucioni në SHBA që merret me fatkeqësitë ka që në 2011, që thekson se Shqipëria është ndër vendet më të prekura në botë nga përmbytjet. Duhet t'i mësojmë parapërgatitjes dhe menaxhimit të mbrojtjes së këtyre. Si vend kandidat i BE-së duhet të përmbushim direktivën e BE për përmbytjet. Ishte e detyrueshme të përmbushej në 2014. Sipas raporteve vit pas viti shtyhet data për përmbushjen e direktivës. Sot flitet që do përmbushet në 2023 që ka të bëjë me parandalimin dhe masat në dhe pas përmbytjes. Ne jemi të pambrojtur dhe nuk e kemi realizuar këtë objektiv”.

mbi 3 mijë euro në vit prime sigurimi. Kjo ka disa arsye, por themelore mbetet kultura e pakët e shqiptarëve në tërësi. Marrja e përgjegjësisë nga qeveria e cila ka kërkuar në të gjitha rastet e fatkeqësive ka qenë pranë tyre dhe fermerët e mbajnë mendjen nga shteti. Vijnë nga një sistem diktatorial ku çdo qytetar mendon se do t'i zgjidhë shteti”.

Ai thotë se primet e sigurimit për kulturat bujqësore janë mjaft të ulëta dhe janë disa lloj skemash, por Shqipëria është shumë larg asaj që kërkohet.

“Primet e sigurimit për kulturat bujqësore janë tarifa mjaft të ulëta. Nëse për një apartament primi është 50 mijë lekë të vjetra në vit, kaq është edhe për tokat bujqësore që mund të përmbysen. Ka disa lloj skemash për sigurimet. Nuk mund të marrësh në sigurim një shtëpi apo objekt që përmbysen çdo vit se ai është i ekspozuar. Po të shohësh hartën Shqipëria është zonë e kuqe nga veriu në jug për shkak të përmbytjeve dhe tërmeteve. Ne jemi shumë larg asaj që kërkohet apo që është e domosdoshme për ta bërë. Një vit që e morën fals përfituan, vitin e dytë që duhet të paguanin vetë, nuk pranuan”.

Sipas Ponarit, tregu i sigurimeve ofron të gjitha llojet e mbulimeve për bujqësinë nga fatkeqësitë natyrore.

“Tregu i sigurimeve është i

edhe sasinë e prodhimit në çdo vit. Kjo është një eksperiencë e madhe në botë. Ne jemi vend i vogël që ka më shumë potencial dhe mundësi manovrimi dhe gjetje rrugësh për ta bërë këtë. Është thjesht ndërtimi i programeve dhe strategjive për ta mbështetur dhe për t'i dhënë mundësi fermerit”.

Ponari thekson që sigurimi nuk duhet të jetë i detyrueshëm me ligj por sugjeron që çdo qytetar të mund të marrë pjesë në rreziqe katastrofike. Ai pranon që modelet e fermerëve që sigurohen, ekzistojnë në Shqipëri.

“Sigurimi nuk duhet të jetë i detyrueshëm, është pjesë-marrje në rreziqe katastrofike ku merr pjesë çdo qytetar me 2, 5, 10, 15 euro por jo ligj i detyrueshëm. Nëse ti paguan 15 euro ti paguan jo vetëm për vete, për shtëpinë tënde por edhe për atë që përmbysen dhe katastrofa dhe bën të mundur mbulimin nga rreziqe katastrofike, një modul ky që e kanë bërë shumë vende. Ka dhjetëra fermerë dhe ferma që sigurohen çdo vit. Nuk mund të them që Shqipëria nuk ka eksperiencë në këtë fushë, ekzistojnë sigurimet”.

Për kreun e Këshillit të Agrobiznesit Shqiptar Agim Rrapaj, problemi i mos sigurimit është ekonomik pasi, shumica e fermerëve nuk ta përballojnë primin. Sipas tij duhet kombinim fermer-shtet-

është e pamundur që të themi se do ta paguajë fermeri nuk mund ta paguajë fermeri”.

Për ekspertin Uran Derri problem është informaliteti dhe një sërë faktorësh që nga mos subvencionimi dhe mbështetja në bujqësi. “Është një kompozim faktorësh. Aspekti i mentalitetit ndikon shumë po nuk besoj që kjo qëndron te sektori i bujqësisë. Faktori kryesor është mos subvencionimi e mos mbështetja ndaj bujqësisë. Ata nuk përballojnë dot asnjë lek shtesë. Primi nuk është 50 mijë lekë të vjetra, por përcaktohet në bazë të riskut. Fermeri është i pasiguruar. Problem është informaliteti”.

Kurse eksperti Ilir Pilku nuk e shikon problemin tek informaliteti. “Unë nuk jam dakord me çështjen e informalitetit toka bujqësore rreth 20% është e paazhurnuar, familjet bujqësore kanë regjistrat kadastrale e niptet dhe kaq është e majftueshme për sigurimin në bujqësi”.

Ndërsa kreu i Emergjencave Civili Haki Çako apelon për marrjen e përgjegjësisë të gjithsecilit në rast fatkeqësive natyrore. “Nuk mundet që një shoqëri e tërë të mos sigurojë asgjë. Do të dojë kohën e vet se është një zinxhir i tërë. Të ndërgjegjësohemi që kur ndodh fatkeqësi natyrore të marrim përgjegjësitë. Duhet të jemi të gjithë përgjegjës”.

INFORMACIONE

Projekte të përbashkëta ndërkufitare në Ballkanin Perëndimor në bujqësi

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural në bashkëpunim me Këshillin për

sektorin e bujqësisë dhe agrobiznesit.

Ministria e Bujqësisë dhe



Bashkëpunim Rajonal, synojnë nxitjen e projekteve të përbashkëta ndërkufitare në Ballkanin Perëndimor, në

Zhvillimit Rural, Frida Krifca priti në një takim Sekretaren e Përgjithshme të Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal,

Majlinda Bregu, me të cilën diskutoi mbi mundësitë e bashkëpunimit midis dy institucioneve, për iniciativë që kontribuojnë në rritjen e punësimit të rinjve në sektorin rural dhe i japin një hov zhvillimit të këtij sektori sipas standardeve më të mira.

“Energjike biseda me Majlindën për mundësitë e bashkëpunimit mes Ministrisë dhe Këshillit për Bashkëpunim Rajonal”, u shpreh Krifca.

Ministria vuri në dukje se, fokus i takimit ishte nxitja dhe angazhimi i rinisë në bujqësi.

“Gjithashtu, – tha Krifca, – inovacioni, aplikimi në teknologji të reja dhe projekte të përbashkëta ndërkufitare në Ballkanin Perëndimor, ishin disa nga çështjet e tjera në diskutimin e përbashkët.”

Krifca: Rritje e mbështetjes financiare për bujqësinë e turizmin

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, së bashku me Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë organizuan takimin e Komitetit Drejtues të “Programit të Mbështetjes së Agrobiznesit dhe Turizmit”.

Në takim morën pjesë ministrija e Turizmit dhe Mjedisit, Mirela Kumbaro, zëvendësministri i Financave, Besard Kadia, drejtoresha e institucioneve financiare të Ballkanit Perëndimor dhe Evropës Juglindore, Aleksandra Vukosavljevic, drejtoresha e BERZH në Shqipëri, Ekaterina Solovova, si dhe CEO i bankës OTP, Bledar Shella.

Ministria Krifca tregoi mekanizmat me të cilat do të mbështetet agrobiznesi dhe turizmi.

“Ky Program ofron dhe do të vazhdojë të ofrojë mbështetje në linjë të dedikuara kreditimi për agrobiznesin, lehtësim të agrobiznesit për ndarjen e riskut, dhënie të incentivave në nivel 10 % për investime për agrobiznesin si dhe asistencë teknike”,

tha Krifca në fjalën e saj.

Programi është pjesë e përpjekjeve të koordinuara të BERZH, qeverisë shqiptare dhe

milione euro të akorduar nga marrëveshja me BERZH, Ministria e Bujqësisë dhe ajo e Turizmit kanë angazhuar 36 milionë



BE për përmirësimin e qasjes në financime për SME-të shqiptare që zhvillojnë aktivitetin në këto sektorë. Rreth 180 milionë euro janë alokuar për këtë program për hua dhe përmes ndarjes së riskut me bankat partnere në vend. Prej fillimit të tij në 2016, mbi 70 milionë euro hua janë ofruar për rreth 6100 biznese vendase në sektorin e agrobiznesit.

“Si pjesë e fondit prej 180

euro për mbulimin e humbjeve të para si një masë shtesë për t'i ardhur në ndihmë secilit subjekt apo individ që aplikon”, tha Krifca.

Në përmbyllje të fjalës së saj, ministria ritheksoi angazhimin maksimal për të garantuar funksionimin e të gjithë mekanizmave për të zvogëluar distancën mes tokës prodhuese dhe institucioneve financiare.

Memorandum mirëkuptimi mes Universitetit të Miçiganit dhe atij Bujqësor në Kamëz

Kryeministri Edi Rama ka zhvilluar një vizitë në Universitetin Shtetëror të Miçiganit ku gjithashtu ka takuar edhe Dekanin e programeve të studimeve ndërkombëtare, Steven Hanson.

Ky takim thekson Rama u zhvillua për rrugën e hapjes së universiteteve tona ndaj universiteteve ndërkombëtare.

Gjatë vizitës në këtë universitet Kryeministri shoqërohet nga ministria e Arsimit dhe Sportit, Evis Kushi.

“Në Universitetin Shtetëror të Miçiganit me Dekanin e programeve të studimeve ndërkombëtare, Steven Hanson dhe ekipin drejtues të këtij universiteti prestigjioz amerikan, në rrugën e hapjes së universiteteve tona ndaj universiteteve ndërkombëtare, me programe e projekte të përbashkëta, të cilat do t'u mundësojnë të rejave e të rinjve shqiptarë studime të nivelit të lartë pa u larguar domosdoshmërisht nga Shqipëria”, shprehet Rama.

Pasi vizitoi ambientet e këtij universiteti Rama tha se, “ishte një vizitë e jashtëzakonshme nga pikëpamja e interesit për të krijuar këtë lidhje mes këtij universiteti shumë të famshëm

dhe prestigjioz në SHBA dhe universitetit tonë Bujqësor dhe jo vetëm”.

“Pasi kemi vendosur një marrëveshje mirëkuptimi mes ministres dhe drejtueses së programeve ndërkombëtare këtij universiteti ne presim

këtë të Miçiganit”, u shpreh Rama.

“Kjo është një miqësi që lindi nga një tjetër miqësi mes universitetit të Miçiganit dhe profesorëve të këtij universiteti në Afganistan që ne i kemi strehuar në Shqipëri.



në fillim të vitit të ardhshëm të kemi një vizitë pune për të parë se si do të ecim më tej në mënyrë që t'i japim një forcë të re universitet tonë Bujqësor dhe jo vetëm. Pra të krijojmë një hapësirë për studentët tanë që të mund të qëndrojnë në Shqipëri dhe të mund të studiojnë me kushtet dhe cilësinë më të lartë që ofrojnë universitetet e huaja përfshirë edhe

Në këtë mënyrë kemi hapur një derë të re me miq e partnerë të rinj që do sjellin në Shqipëri më shumë dije e mundësi për të rinjtë tanë”, tha Rama.

Kurt Richter, profesor në Universitetin e Miçiganit, tha se në muajt në vijim një trup e këtij universiteti do të vizitojë Shqipërinë për të vijuar më tej me marrëveshjen.

Të rikthehesh në fshat - Të moshuarit që zgjedhin sërish jetën rurale pas shumë vitesh në qytet

Zef dhe Dila Gjoka kanë lidhur jetën së bashku para 57 vitesh në fshatin Kalur.

Krijuan familjen në këtë fshat dhe jetuan deri në vitin 2000 e më pas vendosën të jetonin në Lezhë, por iniciativa e djalit të tyre dhe më shumë dëshira e dy të moshuarve bëri që të kthehen pas 20 vitesh përsëri në fshatin Kalur për të jetuar.

Gjatë bisedës me ta ata u rikthyen pas në kohë duke treguar për të kaluarën në këtë fshat dhe punën që Dila bënte në kooperativë.

E zonja e shtëpisë mban veshur veshjen tradicionale të Mirditës dhe na tregon më tepër rreth kësaj veshje, e ndërsa i zoti i shtëpisë Zefi tregon për pa-

sionin e tij për leximin ku veçon librin “Rmo për me tregue”.

vite jetë pasi janë rikthyer në fshatin që me zemër nuk e braktisën kurrë dhe që pleqërinë duan ta kalojnë në këtë fshat.



Ata ndihen të plotësuar dhe shprehen se janë shtuar shumë

tisën kurrë dhe që pleqërinë duan ta kalojnë në këtë fshat.

Përmbytjet, Rrapaj: Tokat nuk rikthehen në aktivitet prodhues për këtë sezon dhe fermerët detyrohen të largohen

(Vijon nga faqja 5)

fatkeqësitë natyrore. Përmbytjet e ditëve të fundit kanë shkaktuar shumë dëme te fermerët. Kreu i Emergjencave Civile Haki Çako tha se përmbytjet janë prioritet i qeverisë dhe po harton strategji kombëtare për zvogëlimin e riskut.

“Qeveria ka ndërmarrë reformë për zvogëlimin e riskut dhe në ligj janë parashikuar direktivat e BE, në bazë të analizave të bëra në vend. Faktorët janë të shumtë. Shqipëria është e ekspozuar jo vetëm për problematikat por edhe pozicionit gjeografik e hidrik ku prej 30 vitesh investimet kanë qenë jashtë vëmendjes. Janë

miratuar elementët për të hartuar strategji kombëtare për zvogëlimin e riskut”.

Pas tërheqjes së ujit nga zonat e përmbytjeve kryesisht në Fier dhe Vlorë, Çako tha se do të bëhet vlerësimi i dëmeve. Sipas tij disa banesa janë jashtë vijave të verdha për ndërtime.

“Fatkeqësitë natyrore prevalojnë mbi të tjerat, se edhe lumenjtë kur dalin nga shtrati bëhen prezent te zonat e fermerëve dhe zona të banuara që janë jashtë vijave të verdha apo zonave urbanistike. Janë jashtë kuotave për të qenë zona ndërtimi e urbane. Reshjet e ditëve të

fundit që sollën vërshimin e lumi Vjosa angazhuan të gjithë strukturat, por është faza e vlerësimit të dëmeve. Këtë herë ndonëse pati kapacitet ekstremisht të lartë nuk prodhoi pasojë të jashtëzakonshme falë investimeve të qeverisë në argjinaturat e Fierit dhe Vlorës, që mundësuan futjen në korridor. Kanë qenë 30 banesa në të dy njësitet administrative të bashkive. Banorët janë rikthyer në banesa. Por ndonëse uji është tërhequr, pritet të thahet plotësisht për vlerësimin e dëmeve”.

Në lidhje me kompensimet Çako tha se modalitetet janë të përcaktuara për çdo rast. Sipas tij

janë akumuluar 7.5 milionë euro dhe vit për vit planifikohet buxhet për t'i kompensuar dëmet.

“Ngatërrohet kompensimi me dëmshpërblimin. Qeveria dhe shteti nuk bëjnë dëmshpërblim, por kompensim. Sa para do marrin? Modalitet janë të përcaktuara, janë dosjet për çdo rast. Janë detyrime e debi që u përkasin qytetarëve. Ne kemi të akumuluar 7.5 milionë euro dhe vit për vit planifikojmë pjesë të buxhetit për t'i kompensuar ato për të gjitha dëmet e shkaktuara. Këto datojnë që nga viti 2010. Ligji ka adresuar kompensimin të pushetëti vendor. Është një nga fat-

keqësitë natyrore në Shqipëri më pas vijnë zjarret e tërmetet”.

Sa i takon ligjit për mbrojtjen civile, Çako theksoi se ai është i ndërtuar në bazë të disa direktivave që lidhen me shumë investime, por deri më tani janë identifikuar zonat e riskut të lartë dhe po punohet për të përcaktuar qartë riskun.

“Ligji për mbrojtjen civile është ndërtuar në disa direktiva, por çështja e direktivave të BE lidhet me shumë investime, jo vetëm buxhetore por me përcaktimin e zonave të rrezikut dhe përmbytjes që janë duke u suportuar nga BE. Po punojmë

për strategji kombëtare për zvogëlimin e riskut. Me urdhër të kryeministrit janë bashkuar institucionet me ekspertët më të mirë. Janë identifikuar zonat e riskut të lartë. Nëse merremi me rezervuarët apo të tjerë që nuk përbëjnë rrezikun kryesor të përmbytjeve është çështje tjetër. Ne flasim për përmbytjet nga vërshimi i lumenjve si Vjosa, Drini, Buna, Ishmi, Erzeni dhe për këto po punohet intensivisht nga institucionet për të përcaktuar qartë riskun. Pa qenë i qartësuar nuk mund të investosh dhe nuk mund të krijosh programe”.

Nënushqyerja dhe niveli i pasigurisë ushqimore në Evropë dhe Azinë Qendrore janë mesatarisht shumë më të ulëta se në pjesën tjetër të botës.

Megjithatë, më shumë se 14 milionë njerëz janë bërë të pasigurt në ushqim, në nivel mesatar ose më rëndë nga viti 2019 deri në vitin 2020, gjatë pandemisë COVID-19.

Për më tepër, me mbipeshën dhe obezitetin mbi prevalencën globale dhe në rritje, 50 vendet e rajonit duhet të rishikojnë angazhimet e tyre për t'i dhënë fundurisë dhe kequshqyerjes deri në vitin 2030, siç parashikohet nga Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDGs).

Të dhënat dhe tendencat më të fundit janë tani të disponueshme në Përmbledhjen Rajonale të Sigurisë Ushqimore dhe të Ushqyerjes në Evropë dhe Azinë Qendrore, publikuar nga Organizata e Kombeve të Bashkuara për Ushqimin dhe Bujqësinë (FAO).

Në dy dekadat e fundit, vendet në rajonin e Evropës dhe Azisë Qendrore kanë bërë përparim të rëndësishëm në veprimet ndaj kequshqyerjes. Në mbarë botën, numri i njerëzve me konsum të pamjaftueshëm të ushqimit u rrit nga 8.4 për qind në vitin 2019, në 9.9 për qind në vitin 2020, ndërsa në Evropë dhe Azinë Qendrore, mesatarja rajonale mbeti nën 2.5 për qind, për gati dy dekada.

Megjithatë, kjo shifër fsheh dallimet nënrajonale: ndërsa numri është i ulët në Bashkimin Evropian, Shoqatën Evropiane të Tregtisë së Lirë dhe midis vendeve evropiane të Shteteve të Pavarura të Komonuelthit, rritje të vogla janë vërejtur në Kaukaz, Azinë Qendrore dhe

Edhe pse në nivele të ulëta në Evropë dhe Azinë Qendrore, shkalla e urisë u përkeqësua nga ndikimi i pandemisë

FAO jep të dhëna dhe analiza të reja mbi situatën e urisë dhe kequshqyerjes në rajon në një format më të shkurtër dhe më kompakt

Ballkanin Perëndimor në dy vitet e fundit.

“Pandemia ka pasur një efekt negativ në sigurinë ushqimore në rajonin e Evropës dhe Azisë Qendrore,” tha Ndihamësdrejtori i Përgjithshëm dhe Përfaqësuesi Rajonal i FAO-s,

u godit nga shpërthimi i pandemisë COVID-19 dhe nga ndërprerjet që rezultuan në tregje, tregtinë dhe zinxhirët e furnizimit me ushqime. Në Evropë dhe Azinë Qendrore, numri i njerëzve me pasiguri ushqimore u rrit me 7 milionë

net në Ballkanin Perëndimor, Azinë Qendrore dhe Kaukaz janë më të larta.

“Në përgjigje të politikave ndaj përballimit të pandemisë që ndryshojnë shumë sipas nivelit të të ardhurave dhe vullnetit politik të secilit vend,

Një vështrim më i thellë i treguesve të të ushqyerit

Është bërë përparim në reduktimin e formave të ndryshme të kequshqyerjes, duke përfshirë (në shumicën e vendeve të rajonit) shtatzëninë e fëmijëve, humbjen e fëmijëve dhe peshën e ulët të lindjes. Megjithatë, Evropa dhe Azia Qendrore janë në një pozitë më të keqe për sa i përket ushqyerjes ekskluzive me gjë, mbipeshës së fëmijëve dhe obezitetit tek të rriturit. Të dhënat dhe tendencat janë alarmante për obezitetin tek të rriturit në të gjitha nënrajonet dhe pandemia mund ta përkeqësojë më tej problemin. Pavarësisht përmirësimeve të fundit në uljen e mbipeshës tek fëmijët, rajoni, me 7.1 për qind, mbetet mbi mesataren botërore.

“Edhe përpara pandemisë, situata në Kaukaz dhe Azinë Qendrore ishte tashmë vulnerabël dhe u bë edhe më shumë në vitin 2020,” tha Cheng Fang, ekonomist i FAO-s dhe autori kryesor i raportit. “Rezistenca e të gjithë rajonit varet nga ofrimi i përpjekjeve solide në këto nënrajone që çenohen. Për shembull, shkalla në rritje e obezitetit të të rriturve po përbën një problem jo vetëm

në vendet me të ardhura të larta, por edhe në vendet me të ardhura të ulëta dhe të mesme të rajonit.

Prevalenca e anemisë në mesin e grave në moshën riprodhuese vitet e fundit mbeti në 17.4 për qind, si në vitin 2000, me norma më të larta në disa vende të Kaukazit dhe Azisë Qendrore afër ose edhe mbi mesataren botërore prej 29.9 për qind.

Për sa i përket ushqyerjes ekskluzive me gjë, rajoni, veçanërisht nënrajonin i Kaukazit dhe Azia Qendrore, ka bërë përparim të konsiderueshëm (nga 31.1 për qind në 41.7 për qind nga 2012 në 2019) edhe pse prevalenca mbetet nën mesataren globale.

Të dhënat globale për peshën e ulët të lindjes kanë treguar një rënie të vazhdueshme që nga viti 2000 dhe tendenca rajonale duket se ka ndjekur të njëjtin model, por i ngadalhtë, me prevalencë rajonale (6.9 për qind) rreth gjysmës së nivelit global. Në rajon, as vendet me të ardhura të larta dhe as vendet me të ardhura më të ulëta nuk e kanë ulur ndjeshëm prevalencën e peshës së ulët të lindjes.

Më shumë detaje janë të disponueshme në edicionin rajonal të vitit 2021 të raportit kryesor të FAO-s, i cili, duke përdorur të dhënat më të fundit të urisë dhe kequshqyerjes, gjurmon përparimin e Evropës dhe Azisë Qendrore drejt përmirësimit të Objektive Globale të Qëndrueshmërisë, me vëmendje të veçantë tek objektivat e Zero Urisë të SDG 2.



Foto: ©FAO/Vyacheslav Oseledko

Vladimir Rakhmanin në parathënien e botimit. “Në këtë këndvështrim raporti kërkon të vlerësojë sesi treguesit e sigurisë ushqimore dhe të ushqyerjes në rajon, nënrajon dhe vendet respektive kanë ndryshuar nën hijen e pandemisë dhe të monitorojë progresin e rajonit drejt arritjes së SDG-ve.”

Në nivel global, viti 2020

në vitin 2020, në 22 milionë (ose rreth 2.4 për qind e popullsisë), ndërsa ata që përjetojnë pasiguri ushqimore në mënyrë të moderuar ose të rëndë (që nuk kanë akses në ushqim të sigurt, ushqyes dhe adekuat) u rrit me 14 milionë në 111 milionë (11.9 për qind e popullsisë totale). Ndërsa kjo është një mesatare rajonale, proporcio-

pabarazitë kombëtare dhe nënrajonale në aksesin në ushqim janë të sigurta që do të rriten,” tha Rakhmanin. “Kjo duhet të trajtohet për të siguruar që rajoni i Evropës dhe Azisë Qendrore të ecë përpara në arritjen e ushqimit dhe ushqyerjes mjaftueshëm për të gjithë, me një zotim për të mos lënë askënd pas.”

Plastika në bujqësi, OKB: Përdorimi i saj kërcënon sigurinë ushqimore

OKB njoftoi përmes një raporti të posaçëm se mënyra “katastrofike” në të cilën përdoret plastika në bujqësi në mbarë botën po kërcënon sigurinë ushqimore dhe potencialisht shëndetin e njerëzve.

Në deklaratë thuhet se se dherat përmbajnë më shumë ndotje mikroplastike sesa oqeanet dhe se ka prova “të pakundërshtueshme” të nevojës për një menaxhim më të mirë të miliona tonëve plastike të përdorur në sistemin ushqimor dhe bujqësor çdo vit.

“Raporti shërben si një thirrje me zë të lartë për veprim vendimtar për të frenuar përdorimin katastrofik të plastikës në të gjithë sektorët e bujqësisë”, tha Maria Helena Semedo, zëvendësdyrektore dhe përgjithshme në FAO.

Të dhënat për përdorimin e plastikës janë të kufizuara, por Azia u vlerësua të ishte përdoruesi më i madh, që përbën rreth gjysmën e përdorimit global. Në raport thuhet se vetëm në një vit në paketimin

e ushqimit janë përdorur 37.3 milionë ton produkte plastike.

Si zgjidhje, FAO citon “modelin 6R” - refuzoni, ridizajnoni, reduktioni, ripërdorni, ricikloni dhe rikuperoni, që nënkupton adoptimin e praktikave bujqësore që shmangin përdorimin e plastikës, zëvendësimin e produkteve plastike me alternative natyrore ose të biodegradueshme, promovimin e produkteve plastike të ripërdorshme dhe përmirësimin e menaxhimit të mbetjeve plastike.

Inteligjenca Artificiale mbjell borzilokun më të mirë në botë

Në eksperiencën e saj prej fermeri, Inteligjenca Artificiale (IA) shfaqet fermerja më e mirë duke mbjellë borzilokun më të pasur në aromë pa asnjë modifikim ADN-je, por falë një algoritmi të të mësuarit automatik që ka përllogaritur miliona të dhëna për të gjetur kushtet optimale për të marrë aromën më të mirë.

Ky studim i bërë nga Instituti i Teknologjisë në Masaçusets (MIT), i publikuar në revistën shkencore “Plos One”,

është hapi i parë i të ashtuquajturit kultivim kibernetik dhe tani studiuesit synojnë të rrisin aftësitë mjekësore të disa bimëve dhe të ndihmojnë mbjelljet që të përshtaten në ndryshimet klimatike.

Të drejtuar nga Arielle Johnson dhe Elliot Meyerson, studiuesit po përpiqen tani të krijojnë bimë borziloku më të pasura me substanca që ndihmojnë në luftën kundër sëmundjeve, si diabeti, si dhe të rrisin rendimentin e

bimëve mjekësore si previnka e Madagaskarit, burimi i vetëm i disa molekulave kundër kancerit.

Një aplikim tjetër shumë i rëndësishëm i kultivimit kibernetik është përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike. Në këtë drejtim, grupi i shkencëtarëve po zhvillon eksperimente me pemët e lajthive për kompaninë shumëkombëshe “Ferrero”, që konsumon 25% të lajthive të mbjella në gjithë botën.

Ligj i ri për SME-të, si kategorizohen dhe çfarë grantesh përfitojnë nga buxheti!

Qeveria ka hartuar një projektligj që synon të përcaktojë përkufizimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme, të përdorur në politikën shtetërore për t'i mbështetur ato, si dhe përcaktimin e politikave në ndihmë të tyre. Ndërkohë drafti i ri shfuqizon ligjin aktual për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.

Kështu sipas projektligjit të miratuar nga qeveria ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të

mesme, janë ato njësi që janë regjistruar në QKB prej jo më shumë se 12 (dymbëdhjetë) muajsh, në të cilat organet publike, direkt ose indirekt nuk mund të zotërojnë më shumë se 25% të kapitalit apo të të drejtave të votës.

NMVM-të janë tërësia e ndërmarrjeve, në të cilat punësohen më pak se 250 persona dhe realizojnë një shifër afarizmi ose një bilanc total vjetor jo më të madh se 250 milionë

lekë.

Ndërmarrje e vogël konsiderohet një ndërmarrje me më pak se 50 persona të punësuar, e cila bilanc total vjetor jo më të madh se 50 milionë lekë. Mikrondërmarrjet janë me më pak se 10 persona të punësuar dhe bilanc vjetor jo më shumë se 10 milionë lekë, ndërsa ndërmarrjet e mesme janë ato 50 deri në 249 persona të punësuar dhe bilanc total vjetor nga 50 deri në 250 milionë lekë.

Bujqësia, në sfidë për konkurrueshmërinë e çmimet - “Tregu rajonal dhe dixhitalizimi, kyç për uljen e kostove dhe integrimin”

Vendet e rajonit kanë një sfidë të përbashkët në sektorin bujqësor, që të jenë një paketë e vetme kundrejt Bashkimit Evropian, duke u bërë më konkurrues në produkte cilësore dhe në çmime. Ministria e Bujqësisë Shqiptare ka marrë presidencën e SWG për vitin e ardhshëm, dhe do të jetë në krye të hartimit të politikave të

përbashkëta rajonale në sektorin bujqësor.

Për Ministrin serb të Bujqësisë, shtet i cili mbante Presidencën, sfidë kryesore rajonale është aplikimi i axhendës së gjelbër dhe teknologjive të avancuara për të përballuar rritjen e çmimeve të energjisë dhe gazit në sektorin bujqësor.

Ndërsa për Bashkimin Eu-

ropian, krijimi i tregut rajonal, eliminimi i barrierave tregtare dhe dixhitalizimi në bujqësi është kyç për tu bërë faktor në tregun evropian.

Problematikat dhe sfidat që ka përpara sektori bujqësor në Shqipëri dhe më gjerë janë bërë prezente në takimin e 15 vjetor të Ministrave të Bujqësisë së Evropës Juglindore.



TASE GROUP

Adresa: Rruga e Kavajës, Qendra Kondor (ish parku i autobuzave, poshtë "21 Dhjetorit"), Tiranë
Tel: 0035542239968; Fax/Tel: 0035542220027; e-mail: info@tasegroup.al;
Website: www.tasegroup.al; Celular: 0684855580 (Kushineta, Premistopa dhe rripa)
Celular: 0672035581 (Pjesë këmbimi për traktorë)



Ofrojmë:

- PJESE MOTORIKE
- FREKSIONE
- PERMISTOPA
- KUSHINETA
- RRIPIA
- AKSE
- PJESE ELEKTRIKE
- PJESE HIDRAULIKE
- VAJRA DHE FILTRA



KASH

Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar

www.kashalbania.org

Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar



KREDI PËR ÇDO SIPERMARRËS

KREDI E SHPEJTË ME NORMA KONKURRUESE

deri në
7 MILIONË
Lekë



Serrat drejt falimentimit

Për të tretin vit, fermat e konsoliduara të serrave po përballen me humbje sidomos në mbjelljet e dyta, si rrjedhojë e rritjes së kostove dhe rënies së çmimeve. Tarifat e larta të inputeve (plehrave, plastmasës, farave etj.) i çuan kostot e prodhimit të një kilogrami domate në 33-35 lekë, ndërsa çmimet e shitjes me shumicë shkojnë 20-30 lekë për kilogram. Fermerët po braktisin mbjelljet, në pritje të një skeme mbështetjeje. Ministria e Bujqësisë është në shqyrtim të një varianti që synon mbështetjen direkte, ose kompensimin e humbjeve.

produkteve.

Vitin e kaluar, eksporti i perimeve shënoi gati 100 milionë euro, por të dhënat nga tregtia e jashtme e këtij viti reflektojnë shqetësimet e fermerëve. Gjatë 10-mujorit, eksportet e perimeve janë rritur me vetëm 1.5% nga mbi 10% në vitet e shkuara.

Çmimet e larta të lëndëve të para kanë dekurajuar shumë fermerë. INSTAT raportoi se, në tremujorin e dytë të vitit 2021, kur shënohet edhe kulmi i vjeljes në serra nga sezoni i parë, prodhimi bujqësor shënoi rënie me 0.6% ndryshe nga sektorët e tjerë të ekonomisë që njohën një rritje jo të zakonshme. Me gjithë problematikën që ka, bujqësia vijon të jetë sektori kryesor i ekonomisë me kontribut 18% në Prodhimin e Brendshëm Bruto (PBB) dhe mbi 44% të totalit të punësim-it.

Kostot janë dyfishuar, çmimet kanë rënë

Historikisht bizneset bujqësore, sidomos fermat prodhuese, kanë vuajtur nga norma të ulëta të fitimit, por së fundmi rritja e kostove të lëndëve të para dhe mungesa e tregut po lë pa mbjellë qindra hektarë tokë për sezonin tjetër. Në zonat e Fierit dhe Lushnjës, këtë vit, ureja shitet 120% më shtrenjtë dhe nitrati gati 250% më shumë se vitin e kaluar.

Gjithashtu janë rritur kostot për të gjitha helmet dhe pesticidet e tjera, plastmasën dhe hekurin e serrave. Fermeri Ziu tha se kostoja kosto e prodhimit të një kilogrami domate tani ka arritur në 330-350 lekë, në varësi të kulturës dhe farës, nga rreth 290 lekë ose 30 lekë vitin e kaluar. Ndërkohë çmimet e shitjes kanë rënë ndjeshëm poshtë kostos. Pikat e grumbullimit nuk po tërheqin domate për shkak të rënies së kërkesës nga rajoni.

Përfaqësues të kompanisë “Gogo eksport”, që eksportojnë kryesisht në rajon, raportuan rënie të kërkesës. Me hyrjen në stinën e dimrit, kërkesa për domate dhe kastravecë pëson rënie, ndërkohë që në serrat shqiptare, prodhimi është njësoj, për shkak se shumica e tyre mbillen dy herë në vit me të njëjtat kultura, domate dhe kastravec, shpjegojnë eksportuesit.

Plehrat kimike dhe pesticidet, përveçse tregtohen me çmime shumë të larta për buxhetin e fermerëve, nuk janë as cilësore.

Ilir Mile, fermer në zonën e Fierit, tha se, prodhimet bujqësore në serra po dëmtohen rëndë nga tregtarët e pesticideve. “Fajin e kanë tregtarët e mëdhenj, që e fusin helmin në Shqipëri të parët. Helmi që

vjen këtu nuk ka lëndën aktive të duhur që të ngordhë insekti, të cilën ata e porosisin qëllimisht nga fabrika, domethënë nga 100% që duhet të jetë, në 50% me kosto më të ulët. Fermeri detyrohet të spërkasë disa herë dhe kostoja rritet disa herë më shumë. Faji tjetër është i shtetit që nuk i kontrollon” – tha fermeri Mile.

Ai dhe fermerë të tjerë të sektorit të serrave fajësojnë hallkat e tjera të zinxhirit bujqësor, pasi ata sigurojnë fitime të larta, ndërsa prodhuesit në shumicën e rasteve, janë të humbur.



Tregu i plehrave në fillim të këtij viti u përfshi në hetim nga Autoriteti i Konkurrencës, i cili gjeti prova se tregtarët e plehrave kimike kishin rënë dakord për të fiksuar çmimet. Në fund të hetimit, të paktën dy kompani u gjobitën me 2 milionë lekë dhe një tjetër 500 mijë lekë.

Alban Zusi, sipërmarrës në sektorin e përpunimit, i cili kohët e fundit është futur në sektorin e prodhimit të inputeve për bujqësinë, thotë se, kostot mund të lehtësohen duke e sjellë prodhimin e një pjesë të plehrave në Shqipëri. Ai tha se Shqipëria trashëgon një përvojë nga e kaluara në këtë drejtim, e cila mund të shfrytëzohet në disa procese në vendin tonë.

Z. Zusi shprehet se mund të importohen ingredientët bazë dhe më pas në Shqipëri të kryhet procesi i përzierjes dhe paketimit. Në këtë mënyrë shkurtohen kostot e transportit dhe hapen mundësi të reja për biznes. Z. Zusi vuri në jetë një projekt që rezultoi i suksesshëm për prodhimin e ushqimeve për pularitë.

Të vënë nën presion nga kostot e larta që po krijon importi i lëndëve të para, shumë kompani dhe biznese po realizojnë disa procese prodhimi brenda vendit, me qëllim shpëtimin e aktivitetit.

Farat jociësore, laboratorët nuk funksionojnë

Genti Ziu mori vetëm 60 kuintalë domate për një dynym serrë, por që të justifikojë mun-

din dhe të nxjerrë të ardhura, ai duhet të vjelë të paktën 100 kuintalë për një dynym serrë. Kur mbolli serrën për prodhimin e dytë të domates, ai tha se bleu farë F1 (Kategoria e parë), por në fakt fara ka rezultuar jociësore, duke mos dhënë rendimentin e duhur.

Një pjesë të humbjeve që pësoi këtë sezon, ai thotë se vjen pikërisht prej farës së keqe. Laboratorët bujqësorë që u ngritën disa vite më parë nuk funksionojnë dhe fara mbillet vetëm me mirëbesim në të shumtën e rasteve. Z. Ziu tha se, në këtë rast është shumë i

shkuan drejt rrënimit këtë sezon, ndërmarrjet e mëdha eksportuese rritën të ardhurat me ritme dyshifrore vitin e fundit dhe gjithashtu ishin me fitim pavarësisht vështirësive që krijoi pandemia. Operatori më i madh i tregut, “Doni Fruit” vitin e kaluar realizoi mbi 1 miliard lekë shitje dhe një rritje 13.5% në krahasim me një vit më parë.

Kompania, e cila nuk ka një histori të gjatë në treg, është një investim nga më të mëdhenjtë në sektorin e grumbullimit dhe eksportit, i vetmi me kapacitete të mëdha frigoriferike që ka hyrë në marrëdhënie kontraktuale me fermerët dhe ka çuar eksportet shqiptare në nivel të ri organizimi.

Kompania tjetër e eksportit, “Tomato Al”, realizoi 824 milionë lekë shitje në vitin 2020, me rritje 24% nga viti i kaluar.

Edhe pse në vit pandemik, operatorët kryesorë të eksportit ruajtën qëndrueshmërinë e shitjeve gjatë pandemisë, të ndihmuar nga përqendrimi i kërkesës rajonale dhe europiane te konsumi i produkteve ushqimore.

Në grupin e vendeve në zhvillim, ku bën pjesë edhe Shqipëria, qeveritë i ndihmojnë prodhuesit në bujqësi si hallka më e rëndësishme e zinxhirit ushqimor, edhe për shkak të vështirësive dhe rreziqeve, me të cilat po përballen kultivimi nga ndryshimet klimatike që po shpeshtojnë thatësitat dhe përmbytjet.

Ministria e Bujqësisë pak më herët këtë vit i dorëzoi një kërkesë Ministrisë së Financave me qëllim që në buxhetin e vitit 2022 t’i shtohen edhe 3 miliardë lekë (24 mln euro) për skemën kombëtare, që ka në themel kompensimin e fermerëve.

Ministria e Bujqësisë kërkon që me këtë shtesë, të shtojë fondet për skemën kombëtare, në një total prej 4 miliardë lekësh, ose 32 milionë eurosh, duke tentuar të 4-fishojë fonde në këtë zë.

Kërkesa për subvencione po rritet vit pas viti, për shkak të organizimit dhe formalizimit më të lartë të fermerëve.

Tani gjithnjë e më shumë fermerë i plotësojnë kushtet për subvencion, por qeveria ofron fonde të pakta në krahasim me vendet e tjera të rajonit dhe Europës.

Në vitin 2019, Kosova e mbështeti bujqësinë me 53 milionë euro nga buxheti i shtetit, Mali Zi me 61 milionë euro, ndërsa Shqipëria me vetëm 6 milionë euro. Me këtë mbështetje, fermerët shqiptarë, jo vetëm nuk prodhojnë me çmime konkurruese, por shpesh përballen me humbje të mëdha, për shkak të kostove të larta që nuk kompensohen nga subvencionet.

Prodhuesit me humbje, tregtarët me fitim

Teksa bizneset e serrave

Domatet dhe kastravecët e serrave dominojnë eksport bujqësore

Domatet dhe kastravecët e serrave janë baza e eksporteve shqiptare të produkteve bujqësore. Sipas të dhënave mbi tregtinë nga Kombet e Bashkuara, në vitin 2020, eksportet e domateve dhe kastravecevë arritën 49.4 milionë dollarë, me rritje 10% në krahasim me vitin 2019, kur vlera e tyre ishte 45 milionë dollarë. Vlera e eksporteve të zarzavateve gjithsej ishte 72 milionë euro vitin e kaluar, 67% e tyre përfaqësoheshin nga domatet dhe kastravecët.

Eksportet e domateve dominojnë, me vlerë 37 milionë euro, duke zënë më shumë se 40% të eksporteve të zarzavateve.

Shumë sektorë të ekonomisë u përfshinë në ngërç nga pandemia Covid-19 vitin e kaluar, por eksportet e prodhimeve bujqësore kanë shënuar rritje të ndjeshme në vitin 2020, tendencë, që ka vijuar me ritme të larta edhe këtë vit.

Sipas ekspertëve, nxitja e eksporteve bujqësore, më shumë se sa nga prodhimi në fushë, po vjen nga përmirësimi i zinxhirëve të tregtisë dhe eksportit, si dhe investimeve në kapacitete frigoriferike.

Sektori me ecurinë tregtare më të mirë brenda sektorëve agroushqimorë është ai i perimeve. Në sektorin e perimeve vihet re një rritje e konsiderueshme e eksporteve, nga pothuajse inekzistent në fillim të viteve 2000, në nivele të konsiderueshme në vitet e fundit, si rezultat i rritjes së nivelit të prodhimit dhe shtrirjes më të madhe (kohore) të kalendarit të prodhimit.

Ndërkohë që Shqipëria ka një deficit tregtar të konsiderueshëm për shumicën e produkteve bujqësore, ajo ka një bilanc tregtar pozitiv për domaten dhe kastravecin. Eksportet e domates dhe kastravecit ndodhin në kushtet e një kërkesë ndërkombëtare të qëndrueshme për këto produkte ndërkombëtare.

Vladimir Çela, i cili kultivon prodhimet e serrave që në vitin 1991, tha se problemi e ka i gjithë zinxhiri që nga farat, pesticidet jociësore, kostot e larta dhe çmimet e ulëta.

“Që të justifikoj mundin, duhet të shes një kilogram domate 50-70 lekë ndërkohë që çmimi në treg nuk është më shumë se 30-35 lekë. Tre vitet e fundit, situata është rënduar nga çmimet e larta të inputeve dhe nga ana tjetër, nga çmimet e ulëta të produkteve finale.

Aktualisht kam 1 milion lekë borxh, ndërkohë që kam investuar në serrë 3 milionë lekë. Nafta pa akcizë që dha qeveria nuk e zgjidh problemin, pasi 70 litra naftë që kam përfituar, kushtojnë 10 mijë lekë, ndërkohë që sot hodha në serrë 30 mijë lekë

INTERVISTA

Takim me agronomin shqiptaro-amerikan Koço Mosko

Përgatiti: Fatos Fico, Londër

Në Vashtëmi, Korçë ndodhet një nga “fermat” e para në Europë, ku njerëzit u morën me bujqësi 8500 vjet më parë. Pak shqiptarë e dinë këtë sepse bujqësia nuk është pjesë e psikës shqiptare.

Agriarizmi sipas enciko-

jmë investitorë atë që ka para e nderton një pallat ngjitur me një pallat tjetër, ndërsa njerëzit

speriencë të gjatë, sigurisht në mbrojtjen e bimëve, drithërave, pemëve frutore, vreshtave dhe

cime e subvencione. Çdo vit organizohen falas për fermerët nga universitete e specializuara

Çfarë është qarkullimi bujqësor dhe pse duhet bërë? Shembuj të mirë dhe të këqinj?



perimeve, tani, këtu në SHBA edhe për lulet.

Nga përvoja juaj si mund të jetë një fermë ideale në Shqipëri sa e madhe, çfarë kulturash, sa punonjës, mjetet, etj.?

Nga vetë origjina ime prej fshati malor, qysh në fëmijëri kam qenë i përkushtuar i gjithi ndaj Natyrës, kështu dëshiroj të kontribuoj në përmirësimin e parametrave jetësorë të saj për t’ua lënë brezave të pacënuar, pse jo edhe të përmirësuar.

Kanë qenë dy kopshte me rreth 4-5 ha secili, në qytetin e Gjirokastrës: Alizani nga ana e veriut dhe Xhemaliu nga jugu. Ishin kopshtije me pemë, perime e gjithë llojet e bimëve, mbanin edhe disa bagëti. Kishin një organizim të përsosur shumë modern për kohën e bëhen të lakmueshem edhe për kohën tonë të sotme. Në atë periudhë shumë i lakmuar, i stolisur bukur ka qenë edhe “Kopshti i Beut” në Libohovë.

Dëshira ime do të ishte të kisha një fermë komplekse sipas kësaj tradite. Madhësia e fermës mendoj se mund të ishte 15-30 ha. Do të kultivoja llojet e pemëve vendase, të trashëguara dhe do të përzgjidhja farërat më të mira të traditës të bujqëve autoktonë. Do të mbillja edhe pemë të egra ose gjysmë të egra si thanë, mana, ndonjë lis a lofate për ushqim kafshësh, etj. Mendoj se do të nevojiteshin rreth 30 punëtorë gjatë gjithë vitit. Një park me mjete mekanike e agregatë bujqësorë, të paktën dy-tre traktorë, makina transporti, pirun ngarkesë, etj. Do të kishte një pikë shitje të produkteve, një restorant dhe guidën turistike, veçanërisht për fëmijë, etj. Nuk do të mungonin edhe bllokët.

Një fermer në SHBA mjafton të ketë tokë dhe çdo gjë ia ofron tregu, duke filluar nga farërat, shërbimet, punimet me mekanikë, spërkatjet, plehërimet, etj., mendoni se kjo është mirë apo keq? A lidhet kjo me fitime më të ulëta nga ferma?

Nuk është tamam kështu, por të jesh një fermer në SHBA, aq sa di unë ke ndihmën e vazhdueshme të shtetit, që nga krijimi i fermës e në çdo situatë që kalon ferma, duke filluar me programe, këshillime, finan-

seminare e biseda disa ditore për problemet që janë shfaqur si dhe për aplikimin e teknikave dhe teknologjive të reja. Subvencionohen një pjesë e mirë e kulturave bujqësore në bazë prodhimi. Mbulohen humbjet nga lëvizja e çmimeve në treg si dhe mosarritjen e rendimenteve të planifikuara për shkaqe të ndryshme. Tregu i shitjes së prodhimeve është pothuajse i garantuar me rregullimet e ndërhyrjet që bën edhe shteti në disa raste. Fermerët janë të organizuar në kooperativa të cilat ndihmojnë për çmimet e blerjes së inputeve bujqësore, ekziston ndihma me mjete mekanike, operimi në treg, etj. Sigurisht të gjitha këto ndikojnë ndjeshëm në rritjen e fitimeve të fermave dhe bëjnë që ato të kenë një qëndrueshmëri financiare të shëndoshë.

Si mendoni se ku ndryshon një fermer shqiptar nga sa ju parashtruat më sipër?

Me keqardhje po përgjigjem se ndryshimi është shumë i madh. Fermeri shqiptar është i braktisur totalisht, i pambrojtur nga shteti. Nuk ka pothuajse asnjë lloj ndihme nga këto mundësi që përmendëm më lart dhe nuk duket as ne horizont për mirësimin e gjendjes si: subvencionet, të ketë të paktën këshilla, programe e udhëzime prej specialistëve.

Fermerët atje nuk ndihmohen në tregtimin dhe evadimin e prodhimeve bujqësore. Fermeri atje nuk është i mbrojtur nga spekulantët e tregtimit të imputeve bujqësore, farërave, apo infeksioneve nga objektet karantinore dëmtuese të bimëve. Këto mund të vijnë kryesisht nga jashtë vendit, por edhe nga brenda territorit. Jo rrallë ndodh të jenë edhe të qëllimshme si rrjedhojë e konkurrencës ose keqdashjes. Kjo u konstatua qartë kohët e fundit nga fara e gabuar e domates që u ishte shitur fermerëve dhe askush nuk mbajti përgjegjësi. Shteti në këtë rast u fsheh dhe bëri të paditurin. Shembuj të tillë negativë ka patur edhe më parë. Këto fakte flasin qartë se sa i braktisur e i pambrojtur është fermeri në Shqipëri. Për të mos përmendur vjedhjet, siç ndodhi disa ditë më parë në një stallë lopësh.

Qarkullimi bujqësor është një hallkë shumë e rëndësishme e agroteknikës së kultivimit të bimëve bujqësore. Ka të bëjë ose ndikon në rendimentet e kulturave bujqësore, pjellorinë e tokës. Praktika bujqësore tregon se kur toka mbillet për shumë vite me të njëjtën kulturë (monokulturë), veçanërisht me drithëra, pakësohen ndjeshëm lëndët ushqyese në tokë si dhe shfaqen sëmundje e dëmtues të rrezikshëm të bimëve, si rrjedhojë rendimenti dhe prodhimi binte. “Toka është e lodhur” thuhej në këto raste, e që ishin jo të pakta në atë kohë. Për disa vite këto toka lireshin djerrë. Gjatë punës sime kam hasur plot shembuj të tillë. Meqë plani i drithërave, kryesisht gruri, vinte i lartë, disa toka i mbillnin vazhdimisht me drithëra, merrnim një rendiment shumë të ulët, megjithëse përdornim edhe plehra kimike, ndonjëherë edhe organike, hidhje 3kv/ha farë e merrje 5-7 kv/ha. Këto toka i shkatërronte edhe erozioni se plugoheshin çdo vit, bëhej një masakër e paparë ndaj mjedisit. Shembull i mirë është lugina e Drinos që në strukturën e mbjelljeve të kësaj lugine, jonxha si një përmirësuese shembullore e pjellorisë së tokës, zinte një sipërfaqe të konsiderueshme në qarkullimin e kulturave.

Pse e si duhet ruajtur toka? A rikthehemi dot mbrapsht kur toka është e mbushur me kimikate dhe e bëjnë atë shterpë?

Një specialist bujqësie e di mirë se çfarë rëndësie ka menaxhimi i drejtë i tokës bujqësore si një organizëm i gjallë. Kur je duke ngritur një fermë me bimët e arave, së pari duhet të mendosh se si të ruash pjellorinë e tokës. Ndodh sot që fermeri i joshur nga fitimet e çastit ose dhe nga padija, e shfrytëzon shumë egër tokën, duke përdorur kimikate të shumta. Këto toka për disa vite dalin jashtë përdorimit. Mbetet kimike në tokë bëhen shumë të rrezikshme për organizmin e njeriut dhe vetë bimën kur toka mbingarkohet me plehra e trajtime kimike të shumta. Ndoten edhe ujërat, burimet e lumenjtë. Është e vështirë të kthehen këto toka në gjendjen e tyre natyrale, duhet shumë kohë

e shpenzime. Në socializëm kishim një Institut të Tokave dhe laboratorët e tokave nëpër rrethe ku kryheshin analizat e tokës. Nuk e di nëse ka ende ndonjë bërthamë të tij? Kjo për mendimin tim është më se e domosdoshme, madje duhen kryer sondazhe si dhe analizat e prodhimeve bujqësore që shkojnë në treg për të ruajtur shëndetin e popullit. Për të ruajtur pjellorinë e tokës duke përdorur sasira të kontrolluara të plehrave kimike, duhet të futim në qarkullim bimët azotofiksuese si jonxha, tërfili, fasule e bishtajoret e tjera, kurse në zonat mbi ujë një bimë e mirë është trëndelina.

Si ka qenë më parë bujqësia, përpara socializmit, e sot?

Shpendët, dhitë, lopët dhentë kanë qenë një burim i rëndësishëm ushqimi dhe të ardhurash për fshatin. Dhite dhe lopët në traditën Molose janë pa shpenzime, si u thotë populli “të uruara”, përmenden që në Lashtësi. U hap derën e vathës në mëngjes e i lëshon të kullosin malit dhe në darkë kthehen e të mbushin kusinë me qumësht bio. Gjithashtu janë dhe burim mishi. Një miniferme familjare para socializmit, kishte mesatarisht: 1-3 ha tokë, 10-15 kokë dhi, 10-15 kokë dhen, 1-2 lopë, një kafshë ngarkese, 15-20 pula, një derr dhe dy qe të punës. Këtë gjendje le ta kishim edhe tani për fshatin. Familjet që jetojnë sot në fshat po të kishin këto bagëti, sa do të ishte numri i tyre? Me një miniferme të tillë dhe ndonjë aktivitet ndihmës e përballojë jetesën e nuk kish nevojë të emigrojnë. Qeveria Rama mendon se bujqësia mund të zhvillohet vetëm me ferma të mëdha, të përqendruara, ose nisma si ajo me 100 fshatra turistike, por kjo është kryekëput gabim e me pasoja që tani po i vuan fshati dhe bujqësia po kalon një periudhë të keqe, rrudhje. Sot për sot kullotat nëpër fshatra mbeten të pashfrytëzuara. Gjithashtu qeveria duhet të krijojë rend e qetësi se siç kemi dëgjuar të vjedhin lopën ose viçin nga oborri shtëpisë. Pjesa më e madhe e banorëve në fshat sot janë të moshës së tretë dhe e kanë të vështirë të merren me hajdutët.

Të drejtosh bujqësinë duhet një agronom a veteriner i mirë, apo një menaxher i mirë?

Të drejtoshnjë fermë bujqësore ose blegtorale duhet të jesh doemos specialist i fushës përkatëse. Këtë e kam vërejtur kudo, këtu në feramat që kam shkelur ose kam punuar. Pronarët e fermave kujdesen se kujt do t’ia besojnë fermën bujqësore prej një nga pasardhëve e tyre. Atë e pajisin me kulturë agronomie dhe e ndihmojnë të vazhdojë shkollat bujqësore për agronomi. Këtë e bëjnë edhe kur duan të fillojnë një biznes të ri bujqësor. Në Shqipëri kasta drejtuese nuk do që dhe një ministër bu-

(Vijon në faqen 14)

MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT TË BUJQËSISË, SIGURISË USHQIMORE DHE ZHVILLIMIT RURAL

QENDRA E TRANSFERIMIT TË TEKNOLOGJIVE BUJQËSORE FUSHË KRUJË

Gjatë fazës parë të laktacionit, lopët e qumështit janë në një balancë energjike negative për 8-12 javë për shkak se sasia e energjisë dietës është e pamjaftueshme për të plotësuar kërkesat në energji. Për të minimizuar në maksimum këtë balancë energjike negative, në lopët me prodhimtari të lartë, densiteti energjitik i dietës rritet nëpërmjet koncentratës (kryesisht drithrat) si përbërës, megjithatë kjo shpesh shkakton fermentim ruminal të padëshirueshëm dhe rënie të sintezës së yndyrës së qumështit. Përdorimi i yndyrës si suplement, synon rritjen e densitetit energjitik të dietës pa shkaktuar ndonjë impakt negativ në fermentimin në rumen, kur në të ushqyerit e lopëve përdoret koncentrat në sasi relative të mëdha.

Suplementimi me yndyrë i dietave ndodh për dy arsye: i) Aftësia ngrënëse e lopëve me prodhimtari të lartë në fillim të laktacionit është e kufizuar, kështu që ato nuk mund të konsumojnë ushqim të mjaftueshëm për të plotësuar nevojat e tyre dhe për pasojë ato duhet të mobilizojnë rezervat dhjamore për të mbuluar nevojat në energji për prodhimin e lartë të qumështit në fillim të laktacionit. Kjo mund të ketë pasoja negative të tillë si frekuencë e rritur e aqetonemisë dhe çrregullime riprodutive. Përdorimi i yndyrës si suplement në dietat e lopëve bën të mundur parandalimin e humbjeve të madhe në peshë të gjallë të lopëve pas pjelljes dhe shkurtimeve të kohës për rivendosjen e peshës trupore të humbur në fillim të laktacionit; ii) Suplementimi me yndyrë është parë të rrisë efektivitetin ekonomik të dietave. Përdorimi i yndyrës si suplement përmirëson performancën riprodutive, ul incidentet e ketozës dhe rrit prodhimin e qumështit tek lopët. Përdorimi i saj duhet të jetë 2-3% të lëndës thatë të dietës ose në sasi 400-600 g/ditë për lopët me prodhimtari të lartë. Përdorimi mbi këtë sasi në disa studime është shoqëruar me rënie të konsumit të lëndës thatë dhe yndyrës në qumësht. Kjo është parë veçanërisht kur sasia e yndyrës së dietës ka tejkaluar sasinë e nevojitur për sintezën e yndyrës qumështit.

Materiali dhe Metoda

Studimi u realizua në fermën e qumështit ku mbarështohen lopë të racës holshtein të fermerit Ardian Skënderaj, fshati Levan, të Rrethit Fier. Në kërkim u përfshinë 16 krerë lopë që ndodheshin në fillim të stadi parë të laktacionit, me prodhim qumështi përafërsisht të njëjtë dhe të shpërndarë në mënyrë të rastësishme në dy grupe: njëri grup shërbeu si grup kontrolli, dieta e të cilit nuk përmbante yndyrë soje dhe grupi tjetër që shërbeu si grup eksperimenti, dieta e të cilit u suplementua me yndyrë soje në masën 1.84% të lëndës thatë të dietës. Dy javët e para (14ditë) shërbyen si periudhë për përshtatjen me dietat, e ndjekur nga një periudhë 28 ditore e eksperimentit. Dietat u hartuan në përputhje me nevojat në lëndë ushqyese bazuar në normat e NRC-2001. Eksperimenti u ndërtua sipas një skeme katror latin 8 x 2 dhe pati si qëllim të provojë ndikimin që ka përdorimi i yndyrës sojes si suplement,

EFEKTET E SUPLEMENTIMIT TË DIETAVE ME YNDYRË SOJE NË PERFORMANCËN E LOPËVE TË QUMËSHIT TË RACËS HOLSHTAIN

pra rritja e densitetit energjitik të dietës, në prodhimin e qumështit, persistencën pas prodhimit pik, konsumin e lëndës thatë, në treguesit e riprodhimit, kondicionin trupor, në efektivitetin ekonomik të dietës dhe fitimin e realizuar. Për vlerësimin e kondicionit trupor të lopëve u përdor sistemi 5 pikësh. Lopët u vlerësuan në tre stadet e laktacionit: 0-30, 31-100 dhe 101-200 ditë në laktacion. Persistenca e kurbës laktacionit u vlerësua si raport i prodhimit mesatar ditor i qumështit në periudhat e ndryshme të laktacionit: P1 (90-180ditë/0-45ditë) dhe P2 (90-180ditë/0-90ditë). Bazuar në nivelin e prodhimit të qumështit u hartuan dietat ushqimore të cilat siguruan: 21.39 kg lëndë të thatë, 10.40 MJEM (Mega Xhoul Energji Metabolike) dhe 16.80% proteinë bruto /kg lëndë të thatë për lopët e grupit të kontrollit dhe 21.74 kg lëndë e thatë, 10.91MJEM dhe 16.53% proteinë bruto/kg lëndë të thatë për lopët e grupit eksperiment. Struktura e racionit ushqimor ditor (kg fizik/krerë) ishte: Grupi i kontrollit: bari i thatë jonxhe 8 kg, silazh misër kalli 18 kg, misër i bluar 6.0 kg, ermik 1.50 kg, bërsi soje 2.80 kg, premiks 0.20 kg dhe sodë 50 g dhe Grupi eksperimentit: bari i thatë jonxhe 8 kg, silazh misër kalli 18 kg, misër i bluar 6.0 kg, ermik 1.50 kg, bërsi soje 2.80 kg, yndyrë soje 0.40 kg, premiks 0.20 kg dhe sodë 50 g. Sasia e yndyrës që u përdor për grupin e eksperimentit ishte 400g/ditë/krerë ose 1.84% e lëndës thatë të dietës ditore. Për çdo lopë të grupit eksperimentit u përdor 16.8 kg yndyrë soje (14 ditë periudha përgatitore + 28 ditë periudha e eksperimentit). Në lidhje me performancën individuale të lopëve u vlerësuan treguesit: prodhimi i qumështit, persistenca e prodhimit qumësht pas prodhimit pik, treguesit e riprodhimit:PSP dhe SP, pikëzimi i kondicionit trupor, dietat ushqimore të përdorura, sasia e lëndës thatë e konsumuar, shpërblimi ushqimit (kg qumësht/kg lëndë e thatë), kosto e dietës dhe fitimi i realizuar. Të dhënat u analizuan me metodën ANOVA. Për të vlerësuar ndikimin e faktorit “dietë ushqimore” në prodhimin e qumështit u përdor modeli i regresionit linear me faktorë konstantë si më poshtë:

$$Y_{tmr} = \mu + a_t + e_{mr} \quad (\text{modeli 1})$$

ku: Y_{tmr} – vlera e tiparit, variacioni i të cilit u studiua- prodhim qumështi; a_t – efekti i faktorit “dietë”; e_{mr} – efektet mbetëse të modelit. Në këtë model, efekti “dietë” konsiderohet me veprim konstant jo të rastit në kuptimin probabilistik. Vetëm efektet mbetëse të modelit (rezidualet) konsiderohen të rastit me shpërndarje normale $N(0, \sigma^2)$.

Rezultatet dhe diskutimi i tyre

Të dhënat që jepen në Tab. Nr. 1 tregojnë që gjenden diferenca të rëndësishme në prodhimin e qumështit ($P < 0.05$), midis grupit të eksperimentit dhe të kontrollit. Lopët e grupit eksperimentit prodhuan mesatarisht 4.10 kg qumësht/krerë/ditë or 12.51 % më shumë, krahasuar me lopët e grupit kontrollit, F-test ($F_{stat} = 4.806 > F_{crit} = 3.787$). Analiza e variancës e kryer sipas modelit 1 (Tab.

Nr. 3) të mësipërm tregon se faktori “dietë” ka efekt statistikisht të rëndësishëm në ndryshueshmërinë e tiparit prodhim qumështi. Koeficienti i përcaktueshmërisë, $R^2 = 0.309274525$ tregon që afërsisht 31 % e ndryshueshmërisë së tiparit prodhim

Tab. Nr. 1 Prodhimi i qumështit sipas grupeve të eksperimentit, periudha 28 ditë

N/R	Treguesit	Grupi Kontrollit (A)	Grupi Eksperimentit (B)	Dif. +ose-
1	Nr. Krerëve	8	8	-
2	Periudha (ditë)	28	28	-
3	Prodhimi total i qumështit: (28 ditë)	6255	7149	+894
4	Prodhimi qumështit kg/krerë/ditë (s.e.)	27.92±7.03 (2.48)	31.91±3.21 (1.13)	s.e.d. (B-A) 0.96353515*

(* $p < 0.05$, ** $p < 0.01$, *** $p < 0.001$); * s.e.d. (B-A) = $\sqrt{[(S_1^2/n_1) + (S_2^2/n_2)]}$




Fig. 1 Prodhimi mesatar ditor i qumështit (kg/krerë/ditë), periudha 28 ditë

Tab. Nr. 2 F-test për variancën: Prodhimi mesatar ditor i qumështit kg/krerë/ditë

Treguesit statistikor	Gr. Kontrollit	Gr. Eksperimentit
Mesatarja	27.9225	31.9125
Varianca	49.42436429	10.28387857
Nr. vrojtimeve	8	8
Shkalla e lirisë	7	7
F Stat	4.806004266	
P(F<=f) one-tail	0.027631318	
F Critical one-tail	3.78704354	

* $R^2 = 0.309274525$; Gabimi standard (s. e.) = 2.878754313

trupor rezultojnë 2.82 pikë për lopët e

Tab. Nr. 4 Vlerësimi i Kondicionit Trupor (VKT) të lopëve sipas stadeve të laktacionit

Item	0-30 ditë laktacion			31-100 ditë laktacion			101-200 ditë laktacion		
	ditë lakt	VKT	prodh. kg/d	ditë lakt	VKT	prodh. kg/d	ditë lakt	VKT	prodh. kg/d
Gr. Kontrollit									
m±s	18±7.07	2.62±0.53	34.5±12.02	68±21.02	2.66±0.26	27.69±4.91	135±25.05	2.97±0.25	21.2±3.93
s.e.		0.37	0.85		0.06	1.23		0.06	1.01
n	2	2	2	16	16	16	15	15	15
Gr. Eksperimentit									
m±s	18±8.29	2.62±0.25	29.75±1.71	69±19.58	2.83±0.25	28.68±2.98	131±22.57	3.0±0.19	22.64±3.23
s.e.		0.12	0.85		0.06	0.74		0.06	0.97
n	4	4	4	16	16	16	11	11	11

qumështi shpjegohet nga modeli. Të dhënat e vlerësimit të kondicionit trupor të lopëve të paraqitur në Tab. Nr. 4, tregojnë se janë kryer gjithësej 70 vlerësime, në të cilat sipas stadeve të laktacionit 0-30, 31-100 dhe 101-200 ditë rezultojnë 4, 16 dhe 15 respektivisht, për secilin grup të eksperimentit.

Ditë mesatare në laktacion që kanë pasur lopët në ditët e vlerësimit të kondicionit trupor sipas grupeve dhe sipas stadeve rezultojnë 18, 68, dhe 135 ditë për grupin e

kontrollit dhe 18, 69, dhe 131 ditë për grupin e eksperimentit respektivisht. Pra diferenca midis grupeve kanë qënë të papërfillshme për të ndikuar në vlerësim. Vlerat mesatare të pikëve sipas stadeve të laktacionit (0-30, 31-100 dhe 101-200 ditë) janë 2.62, 2.66 dhe 2.97 pikë respektivisht, për lopët e grupit kontrollit dhe 2.62, 2.83 dhe 3.00 respektivisht, për lopët e grupit të eksperimentit. Vlera mesatare për të tre stadet e vlerësimit të kondicionit

grupit të eksperimentit dhe 2.75 pikë për lopët e grupit të kontrollit.

Nisur nga vlerat e rezultuara për secilin stad të laktacionit për të dy grupet, ato janë brenda intervaleve të kufijve optimalë (minimalë dhe maksimalë) për secilin stad laktacioni, por duke bërë një krahasim midis grupit të kontrollit me grupin e eksperimentit shohim se këto

MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT TË BUJQËSISË, SIGURISË USHQIMORE DHE ZHVILLIMIT RURAL

QENDRA E TRANSFERIMIT TË TEKNOLOGJIVE BUJQËSORE FUSHË KRUJË

(Vijon nga faqja 11)

vlera janë pak më të larta për lopët e grupit eksperimentit në stadin e dytë dhe të tretë të laktacionit me një trend drejt vlerave maksimale të kufijve optimalë, ç’ka mund të themi se suplementimi me yndyrë i dietës ka përmirësuar bilan- çin energjistik duke reflektuar në vlerat e kondicionit trupor.

Të dhënat e paraqitur në Tab. Nr. 5 tregojnë se qëndrueshmëria (persisten- ca) e prodhimit qumështit pas prodhimit pik (maksimal), e llogaritur si raporte midis periud- have të ndryshme të laktacionit : P1 (90-180ditë/0-45ditë) dhe P2 (90-180ditë/0-90ditë) rezultojnë 0.77 dhe 0.79 për grupin e eksperimentit dhe 0.73 dhe 0.74 për grupin e kontrollit respektivisht. Duke kra- hasuar vlerat e koeficientëve të P1 dhe P2, vërehet se lopët e grupit eksperimentit paraqiten me një persistencë më të lartë se ato të grupit kontrollit ç’ka mund të themi se suplementimi me yndyrë i dietës ka përmirësuar nivelin energjistik të dietës duke reflektuar në përmirësimin e vlerave të persistencës të kurbës të laktacionit.

Tab. Nr. 5 Vlerësimi i persistencave të prodhimit qumështit

Persistencat	Grupi Kontrollit			Grupi Eksperimentit		
	Raporti i periudhave të laktacionit	Raporti i prodhimit mesatar ditor i qumështit (kg) sipas periudhave	Koef.	Raporti i periudhave të laktacionit	Raporti i prodhimit mesatar ditor i qumështit (kg) sipas periudhave	Koef.
P1	90-180ditë/0-45ditë	22.05/30.67	0.73	90-180d/0-45d	23.15/31.40	0.74
P2	90-180ditë/0-90ditë	22.05/28.5	0.77	90-180d/0-90d	23.15/29.13	0.79

Një persistencë më e lartë gjatë lak- tacionit është i dobishëm, sepse pjesa e ushqimit të koncentruar në racion mund të ulët në qoftëse prodhimi total i njejtë i qumështit prodhohet nga lopët me një persistencë më të lartë gjatë laktacionit dhe një prodhim pik pak më të ulët se një rënie e menjëherëshme në pro- dhimin e qumështit pas prodhimit pik që rrit shpenzimet e prodhimit për shkak të ndryshueshmërisë së madhe të prodhimit gjatë stadeve të laktacionit.

Tab. Nr. 6 Racioni ushqimor ditor (kg/krerë) konsumuar sipas grupeve të eksperimentit

N/R	Lloji i Ushqimit	Nj. M.	Grupi kontrollit	Grupi eksperimentit
1	Bari i thatë jonxhe	kg fizik	8.00	8.00
2	Silazh misër kalli	„	18.00	18.00
3	Misër kokërr	„	6.00	6.00
4	Bërsi soje	„	2.80	2.80
5	Ermik	„	1.50	1.50
6	Yndyrë soje	„	-	0.40
7	Premiks	„	0.20	0.20
8	NaHCO3	„	0.050	0.050
	Totali kg/fizik/krerë/ditë		36.55	36.95
	Totali kg lëndë të thatë/krerë/ditë		21.39	21.74
	Energji Metabolike (MJ)/kg lëndë të thatë		10.40	10.91
	Proteinë bruto (% të lëndës thatë)		16.80	16.53

Lopët e qumështit me një kurbë lak- tacioni të sheshtë konsiderohen të kenë laktacione më persistente se ato me të

EFEKTET E SUPLEMENTIMIT TË DIETAVE ME YNDYRË SOJE NË PERFORMANCËN E LOPËVE TË QUMËSHTIT TË RACËS HOLSHTEIN

njejtën prodhim laktacioni por me një kurbë laktacioni më të mprehtë. Kjo ul koston e di- etës për shkak të përmbajtjes më të lartë të dietës me ushqime vëllimore (ushqimet e thata dhe të njoma) të cilët kanë çmim më të ulët krahasuar me çmimin e koncentratës. Një avantazh tjetër është racioni ushqimor fiziologjikisht më i mirë kur sasira më të vogla koncentrate përdoret si ushqim duke dhënë si pasojë çrregullime më të pakta në proceset fermentative në rumen. Një pro- dhim pik pak më i ulët mund të jetë i do- bishëm edhe për gjirin.

Nga të dhënat e treguesëve të riprodhim- it, para servis perioda rezultoni 43 dhe 54 ditë respektivisht për grupin e eksperimentit dhe grupin e kontrollit. Siç shihet në grupin e eksperimentit intervali pjellje-inseminim l-rë rezultojnë 5 ditë më i shkurtër krahasuar me grupin e kontrollit i cili tregon një trend pozitiv për të ardhur në cikël riprodhimi më shpejt pas pjelljes se lopët e grupit kontrol-

ushqimeve të konsumuar nga çdo lopë të cilat jepen në Tab. Nr.7, tregojnë se lopët e grupit kontrollit kanë konsumuar: 21.39

Tab. Nr. 9 *Kosto e racionit ushqimor ditor (lek/ditë/krerë)

N/R	Lloji i Ushqimit	Grupi kontrollit			Grupi eksperimentit		
		Sasia (kg)	Çmimi (lek/kg)	Vlefta (lek)	Sasia (kg)	Çmimi (lek/kg)	Vlefta (lek)
1	Bari i thatë jonxhe	8.00	12.00	96.00	8.00	12.00	96.00
2	Silazh misër kalli	18.00	6.00	108.00	18.00	6.00	108.00
3	Misër kokërr	6.00	40.00	240.00	6.00	40.00	240.00
4	Bërsi soje	2.80	78.00	218.40	2.80	78.00	218.40
5	Ermik	1.50	30.00	45.00	1.50	26.00	45.00
6	Premiks	0.20	200.00	40.00	0.20	200.00	40.00
7	Yndyrë	-	-	-	0.40	135.00	54.00
8	Na HCO ₃	0.05	75.00	3.75	0.05	75.00	3.75
	Totali	36.55		751.15	36.95	-	805.15

*Çmimi (lek/kg) i barit të thatë të jonxhës dhe silazhit misër kalli, është llogaritur me çmimin e kostove të prodhuar në fermë, ndërsa misri kokërr, bërsia sojës, ermik, yndyrë soje, premiks mineralo vitaminoz dhe sodë me çmimet e blerë në treg.

kg lëndë të thatë/krerë/ditë, duke siguruar: 10.40 MJEM dhe 16.80% proteinë bruto/kg lëndë të thatë, ndërsa lopët e grupit të eks-

ushqyese që kanë lopët e racës holstein në stadin e parë të laktacionit.

Duke ju referuar të dhënave në Tab. Nr. 9, prodhimit i qumështit të realizuar dhe sasisë ushqimit të konsumuar tregoj- në se efektiviteti i konvertimit të ushqimit në prodhim qumështi në lopët e grupit eksperimentit është 0.68 kundrejt 0.77 të grupit kontrollit, ose 11.70 % më e lartë

Tab. Nr. 8 Efektiviteti i konvertimit të ushqimit në prodhim qumështi

Treguesi	Grupi kontrollit	Grupi eksperimentit
kg lëndë e thatë ushqim/kg qumësht	0.77	0.68

perimentit kanë konsumuar: 21.71 kg lëndë të thatë/krerë/ditë, duke siguruar: 10.91 MJEM dhe 16.53% proteinë bruto/kg lëndë të thatë.

Duke ju referuar të dhënave në Tab. Nr.

Tab. Nr. 7 Struktura (% të lëndës thatë) e dietës ushqimore sipas grupeve

Lloji i ushqimit	Grupi kontrollit	Grupi eksperimentit
Koncentrat	42.57	43.51
Të thata	32.16	31.65
Të njoma	25.27	24.84

lit, e cila mund të shpjegohet me efektin e shtimin të yndyrës sojës në dietë.

Dietat ushqimore ditore dhe llojet e

8, struktura e dietës ushqimore për lopët e grupit të kontrollit rezultojnë: 42.57% ush- qime të koncentruara, 25.27% ushqim i

Tab. Nr. 10 Të ardhurat dhe shpenzimet e ushqimit (lek) për të dy grupet e lopëve, periudha 28 ditë

N/R	Emërtimi	Njësia matjes	Grupi Kontrollit (A)	Grupi Eksperim. (B)	Diferenca (B-A) +ose-
1	Nr. lopëve	krerë	8	8	-
2	Prodhim qumështi	kg	6255	7149	+ 894
3	Çmimi i shitjes	lek/kg	46	46	46
4	Të ardhurat	lek	287730. ⁰⁰	328854. ⁰⁰	+ 41124
5	Shpenzimet e ushqimit	lek	168257. ⁶⁰	180353. ⁶⁰	+12096
6	Diferenca Të ardhura-Shpenzime (+ose-)	lek	+ 119472. ⁴⁰	+148500. ⁴⁰	+29028

njomë dhe 32.16% ushqime të thata dhe për lopët e grupit eksperiment: 43.51% ushqime të koncentruara, 27.64% ushqim i njomë dhe 31.65% ushqime të thata. Një strukturë e tillë e dietave është optimale për t’iu përgjigjur nevojave të larta në lëndë

prodhimi i qumështit dhe kostot e dietave ushqimore ditore të përdorur në periud- hën 28 ditore rezultojnë se diferenca në të ardhura midis grupit të eksperimentit dhe kontrollit është 29028 lek.

Fitimi i realizuar nga çdo lopë i grupit të eksperimentit rezultojnë 130.46 lek në ditë më shumë, krahasuar me çdo lopë të grupit kontrollit (Tab. Nr. 12)

(Vijon në numrin e ardhshëm)

Drejtoria e Teknologjive Blegtorale, QTTB-Fushë Krujë:
E-mail: qttbfushekruje@yahoo.com

INTERVISTA

(Vijon nga faqja 11)

Takim me agronomin shqiptaro-amerikan Koço Mosko

jqësie të jetë agronom, sepse më e rëndësishme është partia se ushqimi i popullit. Për ironi të fatit qeveria Rama i vendosi të gjithë prefektët oficerë, kur pjesa më e madhe e qarqeve kanë drejtim bujqësor. Agronomët nuk i duan as në Parlament e as në qeveri. Ky është nënvleftësim që i bëhet bujqësisë, ushqimit të popullit për sot e për të ardhmen. Njëkohësisht ferma kërkon edhe një menaxher të mirë, zakonisht kompanitë e kanë të punësuar, sepse është i rëndësishëm edhe pse prodhimi e gjen më lehtë tregun.

Çfarë lule, peme keni në oborr? Çfarë mund të mbjellin më shumë në Shqipëri? Pse është ideja se bimët aromatike rriten vetëm në mal ose për shitje, ndërkohë që oborret e shtëpive në USA, Europë janë të mbushura me lavande, rozmarinë, rigon, shkurre e peme?

Unë në shtëpi kam mbjellë sherebel, madje dhe çaj mali. Çdo mëngjes kur dal, kënaqem kur i shoh dhe u marr erë. Një vit në kopshtin tim kisha mbjellë edhe rigon. Pëlqej shumë trëndafilat, karafilin, zambak, barbarozin, shpatoren, geraniumet, etj. Këtu në SHBA kam vërejtur se kopshtet ose peisazhet rreth shtëpisë, mbillen më shumë me pemë drunore e shkurre dekorative dhe tapet me bar jeshil. Unë pëlqej eksperiencën dhe traditën e shqiptarëve për kopshtet, veça-

(Vijon nga faqja 10)

për një lloj pesticidi për rrënjët”, tha Ziu

Fitimet shkojnë për tregtarët

Statistikat e Kombeve të Bashkuara tregojnë se Shqipëria, gjatë vitit të kaluar, ka eksportuar 68 milionë kilogram domate. Çmimi i eksportit për një kilogram domate rezultoi 0,55 dollar, ose rreth 60 lekë për kilogramë. Prodhuesit pohuan se vitin e kaluar e kanë shitur domaten te pikat e grumbullimit me nga 30-35 lekë.

Rreth 40% e çmimit të eksportit shkon për grumbulluesit. Çmimet e importit ishin më të shtrenjta se ato të importit. Për vitin 2020, ato arritën në 72 lekë për 1 kg domate. Çmimet e importit për domaten janë më të larta se ato të importit, pasi vendi ynë i blen ato jashtë sezonit.

Fermerët e intervistuar ankohen vazhdimisht se grumbulluesit lokalë u imponojnë atyre çmime shumë të ulëta. Madje shumë fermerë mendojnë se grumbulluesit kryesorë koordinohen mes tyre, për të bërë presion për uljen e çmimeve, ndërsa fermerët, duke qenë të vegjël dhe të paorganizuar në kooperativa/grupe, nuk kanë fuqi të negociojnë për çmimin. Megjithatë, grumbulluesit shpjegojnë se ata blejnë nga

nërisht në zonën rurale. Rreth shtëpisë mbillen bimë për zbuturim, por që kanë përdorim të shumëfishtë. Të marrim p.sh. manin. Krijon gjelbërim, bukurie e freski rreth shtëpisë. Me gjethet e tij ushqehen bagëtitë, mund të rritim krimbin e mëndafshit, fruti është ushqim i freskët për njerëzit dhe pulat, mund përpunohet duke u tharë për stafidhe, të prodhohen lëngje e shurube, deri edhe mund të distilohet për raki, bëhet pekmez, përdoret për ngrohje, lëndë drusore, etj. Pra, kopshti në zonat rurale duhet që t'i shërbejë minifermës që përmendëm më lart. Bimet që mbillen rrotull shtëpisë, për mendimin tim, duhet të kenë sa më shumë përdorime.

Ju publikoni prej kohësh në rrjetet sociale një blog bujqësor me shumë lexues e të suksesshëm, çfarë i tërheq më shumë ndjeksit aty? Çfarë do të donit që ky blog të ishte edhe më i goditur?

Shqipëria ndodhet në udhëkryq midis lindjes dhe perëndimit. Gadishulli Ballkanit që në agim të historisë ka shërbyer si urë lidhëse. Këtej kanë kaluar pothuajse të gjitha bimët e kafshët bujqësore të ardhura nga Azia për në Europë. Natyrisht shqiptarët kanë patur eksperiencën dhe ndikimin e tyre. Mirëpo në historiografinë bimëre populli shqiptar anashkalohet. Kjo nuk thuhet as në

tekstet mësimore në Shqipëri. Njëpërmjet studjuesave seriozë të vendit e të huaj, ne blog me fakte shkencore e historike përpiqem të evidentoj rolin e shqiptarëve. Njëpërmjet historisë bimëre, miteve, legjendave, folkut, etimologjisë, të të dhënave arkologjike, etj. sjell fakte të pakundërshtues dhe të pashkruara e të evidentuara më parë. Në përshkrimin e bimëve të ndryshme sjell dobitë mjekësore e ushqimore të tyre. Kam përshkruar mbi 20 bimë që janë studime të mirëfillta të mijat. Ndjekësit e blogut tim e pëlqejnë këtë, gjithashtu dhe shkrimet e tjera bujqësore shumë interesante të kolegëve të mi të cilat i kam publikuar herë pas here.

SHBA, Kanada prodhojnë grurë me kosto deri katër herë më të lirë sesa në Shqipëri? A duhet që vendi ynë të prodhojë grurë? Mendoni se prodhimi duhet të lidhet me tregun?

Trojet shqiptare kanë kushte të përshtatshme për kultivimin e grurit dhe drithrave në përgjithësi, ka një eksperiencë dhe traditë mijravrëqare. Ka fusha pjellore si: Fusha e Kosovës, Myzeqeja, Fusha e Korçës, Ultësira e Veriut, etj. Sot në Shqipëri importohen mbi 200 mijë ton drithëra, të cilat mund të prodhohen pa vështirësi në vendin tonë. Sigurimi i kësaj sasie në vend, do të bëjë të zihen më shumë njerëz në punë,

të zhvillohen e të popullohen zonat rurale, të rriten të ardhurat e banorëve dhe të shtetit. Do të rritet cilësia e ushqimeve e nuk do të detyrohemi të marrim të fshirat e hambarëve të botës. Si specialist i mbrojtjes së bimëve e njoh mirë rrezikun toksik të sëmundjeve e dëmtuesve të grurit në fushë dhe gjatë ruajtjes në depo si dhe të kimikateve që përdoren në drithrat e bukës. Është e vështirë, për të mos thënë e pamundur që karantina bimëre dhe laboratorët në Shqipëri të kenë garanci për këto.

Gruri është një prodhim bujqësor strategjik, qeveria shqiptare dhe kosovare duhet të bëjnë një marrëveshje që bukën e përditshme të popullit ta prodhojnë vetë si komb, ashtu siç bejnë të gjitha shtetet e kombet që mendojnë për shëndetin e popullit e tyre. Nuk është punë kostoje. Të dy shtetet tona duhet të krijojnë kushte e të ndihmojë fermerët me mjete mekanike e agregatë bujqësorë, të ulët çmimi i naftës, të përjash-tonen nga taksat tregtimi i farërave dhe i inputeve bujqësore, të rritet puna kërkimore shkencore me farërat, etj., të ketë subvencione si dhe tregu i grurit të jetë i sigurtë për prodhuesit e grurit duke ndërhyrë edhe shteti me politika fiskale e grumbullimin i tepricave që nuk shkojnë në treg, etj. Gruri ka mundësi të

ruhet në depo për një periudhë të caktuar kohore.

Një fermeri n.q.s. do t'i jepnit vetëm një këshillë; ajo do të ishte agronomike apo këshillë biznesi? Cila është ajo?

Për fermerët do të kisha këtë thënie të poetit kanadez Brian Brett:

“Bujqësia është një profesion i shpresës.”

Po kështu një politikani n.q.s. do t'i jepnit vetëm një këshillë, ajo do të ishte agronomike apo këshillë biznesi? Cila është ajo?

Këshilla ime për shtetarët dhe politikanët shqiptarë do të ishte thënia e shkencëtarit amerikan në fushën e kimisë dhe të bujqësisë James Mapes: “Bujqësia është burimi themelor i prosperitetit kombëtar.”

Ju mungon një ecje në malet e Lunxherisë? Pse nuk arrijmë ta bëjmë turizmin rural një alternativë, me sa keni parë kur jeni rikthyer herë pas here në Atdhe?

Sigurisht që më mungon shumë. Që kur isha fëmijë e derisa kreu shkollën e lartë, me moshatarët e mi, i ngjitesha çdo vit malit të Lunxhërisë në majën e Marotasë në periudhën kur lulëzonte çaji i malit. Dëshiroj ta bëj edhe tani këtë ngjitje. Turizmi rural është i lidhur shumë edhe me ven-

det historike si dhe objektet kulturore të traditës. Por ne i kemi shkatëruar dhe nuk po i ribëjmë ato siç i bëjnë shtetet e tjera. Në malin e Lunxherisë është një rrugë dhish që mendohej se e kanë ndjekur antigonasit kur qyteti i tyre u dogj nga romakët. Kjo rrugë mund të bëhet një rrugë pelegrina zhi për të rinjtë dhe turistët. Ose një diçka tjetër: në fshatin tim të lindjes, Selckë, është Kisha e Shënepremtes, monument kulture. Është një vepër kulturi që do t'i linte turistët nga e gjithë bota shumë të habitur. Por gjatë periudhës së ashtuquajtur socialiste i “grabitën” 28 ikonat më të mira. Njëra thuhet se është në Muzeun Kombëtar, të tjerat nuk dihen ku janë. Gjithashtu kësaj kishe, në kohë trazirash, i vodhën edhe ikonostasin që kishte vlera të veçanta. Çfarë do të shikojë turisti tani këtu?!

Çfarë materialesh keni tani në dorë për blogun tuaj?

Po përgatis një shkrim të plotë për sherebelën, ashtu siç kam përshkruar edhe bimët të tjera si dafinën, bajamen, trëndelinën, çajin, etj. Gjithashtu kam në duar edhe një shkrim mbi historinë e fshatit tim të lindjes, këngë dasme, këngë dashurie, të dhëna gojore, arkeologjike, historike, legjenda, përralla, portrete, fjalë të rralla, këngë djepi, këngë trim mash, tregime të lashta, etj.

Falemnderit për intervistën dhe bashkëpunimin!

Serrat drejt falimentimit

kut, është po ashtu në Fier. Gjithashtu, përqendrimi më i konsiderueshëm i pikave të shitjes me shumicë mund të gjendet në Fier, përfshi tregun e shitjes me shumicë në Lushnjë, tregu më i madh në vend, tregun privat të shitjes me shumicë në Fier dhe tregun (privat) të shitjes me shumicë në Divjakë.

Qarku i Fierit ku përfshihet Lushnja, gjithashtu zotëron sipërfaqen mesatare më të madhe të fermave dhe sipërfaqen mesatare më të madhe të parcelës. Përqendrimi i prodhimit në zonën e Myzeqesë vjen si rezultat i kushteve të favorshme natyrore dhe përvijës që banorët e zonës kanë në sektorin e bujqësisë dhe në veçanti, serrave.

Serrat më pak se 5 dynym nuk kanë fizibilitet

Fermerët në zonën e Fierit dhe Lushnjës thanë se, ngritja e një serre për treg kërkon të paktën 5 dynymë. Nëse sipërfaqja është më e vogël, nuk gjenerohen fitime edhe në vite normale.

Të dhënat e Ministrisë së Bujqësisë tregojnë se në vitin 2017, në të gjithë vendin, numëroheshin 792 serra gjithsej, nga të cilat, sipërfaqet 2.1-5 dynymë përbëjnë 59% të totalit të serrave. 180 serra janë 5-10

dynymë dhe përbëjnë 23% të totalit, 10-20 dynymë janë 93 serra dhe mbi 20 dynymë janë vetëm 54 serra.

Bujqësia shqiptare është e organizuar në sipërfaqe të vogla dhe vuan nga copëzimi i lartë i tokës si rrjedhojë e funksionimit të Ligjit 7501. Problemet e pronësisë bëhen shpesh pengesë për konsolidimin e tokës dhe zhvillimin e investimeve të reja.

Studimi për zinxhirin e vlerës sugjeron investimet në serra

Ekspertët Imami dhe Shkreli kanë bërë një studim për zinxhirin e vlerës së prodhimeve e perimeve, në të cilin sugjerohet se, investimet në serrat (e thjeshta) pa ngrohje për prodhimin e perimeve sigurojnë fitime më të larta në zinxhirin e vlerave. Duke rritur investimet, ekspertët thonë se serat mund të përdoren për më shumë se një cikël prodhimi brenda vitit dhe në disa zona, deri në tre cikle prodhimi. Kjo e bën këtë lloj investimi shumë përfitues.

Përdorimi i bletëve për polenizimin e domates është gjithashtu një tendencë e re në këtë sektor, që mundëson një cilësi më të lartë të produktit. Ka gjithashtu një numër të kufizuar serrash me ngrohje. Pothuajse të gjithë magazin-

uesit lokalë dhe shitësit e mëdhenj me shumicë kanë bërë investime bashkëkohore në kapacitetet e magazinimit. Qendrat e ambalazhimit, të cilat përfshijnë linjat e pastrimit, seleksionimit dhe ambalazhimit janë gjithashtu një tendencë e re, veçanërisht për eksportuesit e mëdhenj.

Kjo kategori eksportuesish kanë investuar edhe në dhoma frigorifer, megjithëse kjo nuk paraqet një investim tipik për eksportuesit. Vlerësimet e ekspertëve tregojnë se ka ende mundësi të mëdha për të rritur sipërfaqet me serra.

Me qëllim që Shqipëria të shfrytëzojë potencialin e saj, sipërfaqja me serra duhet të rritet në 5000 hektarë, nga rreth 1500 hektarë që kultivohen aktualisht. Serrat me ngrohje qendrore kanë treguar se janë më pak rentabël se serrat e thjeshta me ngrohje diellore, veçanërisht për shkak të kostonë së lartë të lëndës djegëse.

Kështu që, instalimi i sistemeve të ngrohjes me biomasë në serrat me ngrohje qendrore përbën një mundësi që mund të shqyrtohet për financim. Instalimi i sistemeve automatike të kontrollit të temperaturës/klimës në serrat me ngrohje qendrore për të përmirësuar eficiencën e energjisë mund të merret gjithashtu në konsideratë për financim nga bankat

raportojnë ekspertët.

Sektori e perimeve të serës është i orientuar drejt eksportit. Për momentin, shtrirja gjeografike e eksporteve është përqendruar në vendet e rajonit (Kosovë, Serbi, Bullgari, Bosnjë-Hercegovinë) me çmime të raportuara relativisht të ulëta.

Duke qenë se eksportet po rriten shpejt, lind nevoja për të synuar vendet europiane me të ardhura të larta, të cilat janë më kërkuese për sa i përket cilësisë dhe standardeve të produktit. Një tranzicion i tillë do të kërkonte investime në infrastrukturën e marketingut dhe cilësisë, duke përfshirë qendrat e ambalazhimit. Ambientet frigoriferike nevojiten për të ruajtur cilësinë, në rast eksporti drejt shteteve të BE-së, me të ardhura të larta.

Nevojiten gjithashtu investime në kapacitetet e magazinimit dhe mekanizimin brenda pikave të grumbullimit. Shërbimet e transportit drejt destinacionit kryhen nga kompanitë e huaja, kryesisht maqedonase, malazeze dhe të tjera.

Mbështetja për investime në transport, duke përfshirë transportin frigoriferik, duhet të shqyrtohet gjerësisht, duke marrë parasysh nevojën për këtë shërbim, konkurrencën nga kompanitë e huaja të njohura të transportit dhe politikat qeveritare fiskale dhe mbështetëse, thonë ekspertët.

Revista “Monitor”

KËNDI I EKSPERTIT

UNDROP - Deklarata e OKB për të drejtat e fshatarëve dhe punëtorëve të tjerë të fshatit

Përgatitur nga Prof. As. Dr. Eqrem Meçollari

Prej dekadash lëvizjet e shumta të fshatarëve dhe fermerëve, indigjenëve dhe punëtorëve të tjerë të fshatit kanë kërkuar të hartohet dhe miratohet një dokument për të drejtat e këtyre shtresave të popullsisë së botës.

Në vitin 2008, Deklarata e të Drejtave të Fshatarëve – Grave dhe Burrave u lançua nga la Via Campesina, e cila, me mbështetjen e organizatave të tjera të shoqërisë civile, e prezantoi atë në Këshillin e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut.

Teksti më pas u përdor si bazë nga viti 2009 deri në vitin 2019, për të negociuar tekstin e Deklaratës përfundimtare të UNDROP-it. (United Nations Declaration on the Rights of Peasants and Other People Working in Rural Areas). Negociatat u mbështetën nga grupe të shoqërisë civile si La Via Campesina, FIAN International, ose Qendra Evropë e Botës së Tretë (CETIM), por edhe nga akademikë si grupi për të drejtat e fshatarëve të Akademisë së Gjenevës për të Drejtën Ndërkombëtare Humanitare dhe të Drejtat e Njeriut dhe disa Raportues Specialë të OKB-së.

Koncepti i të drejtave të fshatarëve ndërtohet mbi të drejtat e fermerëve të njohura, ndër të tjera, në Traktatin e Bimëve të FAO -s dhe në Konventën për Diversitetin Biologjik.

Traktati Ndërkombëtar për Burimet gjenetike të bimëve për Ushqimin dhe Bujqësinë, (e njohur edhe si ITPGRFA, Traktati Ndërkombëtar Seed apo Traktatit Bimëve është një marrëveshje gjithëpërfshirëse ndërkombëtare në harmoni me Konventën për Diversitetin Biologjik, e cila synon dhe garanton sigurinë ushqimore nëpërmjet ruajtjes, shkëmbimit dhe përdorimit të qëndrueshëm të burimeve gjenetike bimore në botë për ushqim dhe bujqësi (PGRFA), ndarjen e drejtë dhe të barabartë të përfitimeve që rrjedhin nga përdorimi i tij, si dhe njohjen e të drejtave të fermerëve. Ai u nënshkrua në vitin 2001 në Madrid dhe hyri në fuqi më 29 qershor 2004.

Konventa mbi Diversitetin Biologjik (CBD), e njohur jozyrtarisht si Konventa e Biodiversitetit, është një traktat shumëpalësh. Konventa ka tre qëllime kryesore: ruajtjen e diversitetit biologjik (ose biodiversitetit); përdorimi i qëndrueshëm i përbërësve të tij dhe ndarjen e drejtë dhe të barabartë të përfitimeve që rrjedhin nga burimet gjenetike. Objektivi i tij është të zhvillojë strategji kombëtare për ruajtjen dhe përdorimin e qëndrueshëm të diversitetit biologjik dhe shpesh shihet si dokumenti kyç në lidhje me zhvillimin e qëndrueshëm.

Konventa u hap për nënshkrim në Samitin e Tokës në Rio de Janeiro më 5 qershor 1992 dhe hyri në fuqi më 29 dhjetor 1993. Ajo ka dy marrëveshje plotësuese, Protokolli i Kartagenës dhe Protokolli

lin e Nagojës.

Protokolli i Kartagenës për Biosigurinë e Konventës për Diversitetin Biologjik është një traktat ndërkombëtar që rregullon lëvizjet e organizmave të gjallë të modifikuar (LMO) që rezultojnë nga bioteknologjia moderne nga një vend në tjetrin. Ajo u miratua më 29 janar 2000 si një marrëveshje shtesë për CBD dhe hyri në fuqi më 11 shtator 2003.

Protokolli i Nagoyas mbi aksesin në burimet gjenetike dhe ndarjen e drejtë dhe të barabartë të përfitimeve që dalin nga përdorimi i tyre (ABS) në Konventën për Diversitetin Biologjik është një tjetër marrëveshje plotësuese për CBD. Ai siguron një kuadër ligjor transparent për zbatimin efektiv të një prej tre objektivave të CBD: ndarjen e drejtë dhe të barabartë të përfitimeve që rrjedhin nga përdorimi i burimeve gjenetike. Protokolli i Nagojës u miratua më 29 tetor 2010 në Nagoya, Japoni dhe hyri në fuqi më 12 tetor 2014.

Negociatat, të udhëhequra fillimisht nga Bolivia, u iniciuan nga Këshilli i OKB -së për të Drejtat e Njeriut dhe u miratuan përfundimisht nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara

Më 28 shtator 2018, projekt-rezoluta A/HRC/39/L.16 iu paraqit Këshillit të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut, i mbështetur nga 15 vende. Më pas u miratua me 33 vota pro, 11 abstenime dhe 3 kundër si rezolutë e HRC. 39/12

Më 24 tetor, Komiteti i Tretë i Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së mbajti një grup pune të hapur ndërqeveritar për të diskutuar draftin UNDROP, ku komentet u bënë nga përfaqë-

suesit e Bolivisë, Indonezisë, Bashkimit Evropian, Kubës dhe Afrikës së Jugut. Draft Rezoluta (A/C.3/73/L.30) iu prezantua Komitetit të Tretë të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së më 8 nëntor nga përfaqësuesi i Bolivisë me bashkëspansor nga 9 vende. Më 19 nëntor, drafti fitoi mbështetje nga 25 vende. Më pas u dorëzua për votim, rezultati i të cilit ishte pozitiv: me 119 vota pro, 7 vota kundër dhe 49 abstenime. Theksojmë që Shqipëria ka abstenuar.

Në mbledhjen e tij të 55-të plenare më 17 dhjetor 2018, sesioni i shtatëdhjetëtetë i Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara miratoi Rezolutën 73/175, që përmban UNDROP-in si aneks, dhe në hyrje thuhet:

Duke përshëndetur miratimin nga Këshilli për të Drejtat e Njeriut, në rezolutën 39/12 të datës 28 shtator 2018, të Deklaratës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fshatarëve dhe njerëzve të tjerë që punojnë në zonat rurale, miraton Deklaratën e Kombeve të Bashkuara për të drejtat e fshatarëve dhe njerëzve të tjerë që punojnë në zonat rurale, siç përmbahet në aneksin e kësaj rezolute;

Fton qeveritë, agjencitë dhe organizatat e sistemit të Kombeve të Bashkuara dhe organizatat ndërqeveritare dhe joqeveritare që të shpërndajnë Deklaratën dhe të promovojnë respektin dhe mirëkuptimin universal të saj;

I kërkon Sekretarit të Përgjithshëm të përfshijë tekstin e Deklaratës në edicionin e ardhshëm të të Drejtave të Njeriut: Një përmbledhje e Instrumenteve Ndërkombëtare.

Përpara miratimit, përfaqë-

suesi i Zvicrës (një nga vendet e pakta jo në zhvillim që voton pro) deklaroi në lidhje me UNDROP-in se “kërkon të përmbledhë të drejtat e fshatarëve në një dokument të vetëm për të rritur më mirë ndërgjegjësimin për situatën e tyre. Është një sinjal shumë i rëndësishëm politik”.

Pjesët përbërëse Preambula kujton një sërë instrumentesh për të drejtat e njeriut, si konventa dhe deklarata të OKB-së, dhe shumë materiale të tjera të saj. Këshilli për të Drejtat e Njeriut i OKB-së thekson se:

Duke kujtuar parimet e shpallura në Kartën e Kombeve të Bashkuara, të cilat njohin dinjitetin dhe vlerën e qenësishme dhe të drejtat e barabarta dhe të patjetërsueshme të të gjithëve anëtarët e familjes njerëzore si themeli i lirisë, drejtësisë dhe paqes në botë,

Duke marrë parasysh parimet e shpallura në Deklaratën Universale të Të drejtat e njeriut, Konventa Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Racore Diskriminimi, Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, të Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, Konventa për Eliminimin e të Gjitha format e diskriminimit kundër grave, Konventa për të Drejtat e Fëmijëve, Konventa për mbrojtjen e të drejtave të të gjithë punëtorëve migrantë dhe anëtarëve.

Familjet e tyre, konventat përkatëse të Organizatës Ndërkombëtare të Punës dhe të tjera instrumentet përkatëse ndërkombëtare që janë miratuar në nivel universal ose rajonal, Rikonfirmimi i Deklaratës për të Drejtën për Zhvillim dhe se e drejta për zhvillim është një e drejtë e patjetërsueshme e njeriut në bazë të së cilës çdo njeri dhe të gjithë popujt kanë të drejtë të marrin pjesë, të kontribuojnë dhe të gëzojnë ekonomike, sociale, kulturore dhe zhvillimi politik, në të cilin të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut mund të jenë plotësisht realizuar, duke riafirmuar edhe Deklaratën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Popujve Indigjenëve,

Duke riafirmuar më tej se të gjitha të drejtat e njeriut janë universale, të pandashme, të ndërlidhura, të ndërvarura dhe reciprokisht përforcuese dhe duhet të trajtohen në mënyrë të drejtë dhe të barabartë me të njëjtën bazë dhe me të njëjtin theksim, dhe duke kujtuar se promovimi dhe mbrojtja e një kategorie të drejtash nuk duhet të përjashtojë kurrë shtetet nga promovimi dhe mbrojtjen e të drejtave të tjera.

Duke njohur marrëdhënien dhe ndërveprimin e veçantë midis fshatarëve dhe të njerëzve të tjerë që punojnë në zonat rurale, tokën, ujën dhe natyrën me të cilën ata janë të

lidhur dhe nga të cilat ata varen për jetesën e tyre,

Duke njohur edhe kontributet e kaluara, të tashme dhe të ardhshme të fshatarëve dhe të tjerëve njerëz që punojnë në zonat rurale në të gjitha rajonet e botës për zhvillimin dhe ruajtjen dhe përmirësimin e biodiversitetit, që përbëjnë bazën e prodhimit ushqimor dhe bujqësor në mbarë botën dhe kontributin e tyre në sigurimin e të drejtës për ushqim dhe ushqim të mjaftueshëm sigurinë që janë thelbësore për arritjen e synimeve të zhvillimit të dakorduar ndërkombëtarisht, duke përfshirë Axiendën 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm,

Të shqetësuar se fshatarët dhe njerëzit e tjerë që punojnë në zonat rurale vuajnë në mënyrë disproporcionale nga varfëria, uria dhe kequshqyerja, të shqetësuar gjithashtu se fshatarët dhe njerëzit e tjerë që punojnë në zonat rurale vuajnë nga ngarkesat e shkaktuara nga degradimi i mjedisit dhe ndryshimet klimatike,

Më tej të shqetësuar për fshatarët që plaken në mbarë botën dhe rininë gjithnjë e më shumë duke migruar në zonat urbane dhe duke i kthyer shpinën bujqësisë për shkak të mungesës së stimujve dhe mundimit të jetës rurale dhe duke njohur nevojën për të përmirësuar gjendjen ekonomike diversifikimi i zonave rurale dhe krijimi i mundësive jo bujqësore, veçanërisht për rininë në zonat rurale, të alarmuar nga rritja e numrit të fshatarëve dhe njerëzve të tjerë që punojnë në fshat në zonat e dëbuara ose të zhvendosura me forcë çdo vit,

Të alarmuar edhe nga incidenta e lartë e vetëvrasjeve të fshatarëve në disa vende,

Duke theksuar se gratë fshatare dhe gratë e tjera rurale luajnë një rol të rëndësishëm në mbijetesën ekonomike të familjeve të tyre dhe kontributin në ekonominë rurale dhe kombëtare, duke përfshirë edhe punën e tyre në sektorët e pamonetarizuar të ekonomisë, por shpesh janë mohimi i pronësisë dhe pronësisë mbi tokën, aksesin e barabartë në tokë, burimet prodhuese, financiare shërbime, informacion, punësim ose mbrojtje sociale dhe shpesh janë viktimat të dhunës dhe diskriminimit në formë dhe manifestime të ndryshme,

Duke theksuar gjithashtu rëndësinë e promovimit dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijës në zonat rurale, duke përfshirë zhdukjen e varfërisë, urisë dhe kequshqyerjes promovimi i arsimit dhe shëndetit cilësor, mbrojtja nga ekspozimi ndaj kimikateve dhe mbeturinat dhe eliminimi i punës së fëmijëve, në përputhje me të drejtat dhe detyrueset përkatëse të njeriut,

Duke theksuar më tej se disa faktorë e bëjnë të vështirë për fshatarët dhe njerëzit e tjerë që punojnë në zonat rurale, duke përfshirë peshkatarët e vegjël dhe punëtorët e peshkut, blegtorët, pylltarët dhe komunitetet e tjera lokale për të bërë zërin e tyre të dëgjohet, për të mbrojtur të drejtat e tyre njerëzore dhe të drejtat mbi pronësinë dhe për të siguruar përdorimin e qëndrueshëm të n burimet natyrore mbi të cilat ato varet,

Duke pranuar se aksesin në tokë, ujë, fara dhe burime të tjera natyrore është një sfida në rritje për njerëzit ruralë dhe duke theksuar rëndësinë e përmirësimit të aksesit në burimet prodhuese dhe investimet në zhvillimin e duhur rural,

Të bindur se fshatarët dhe njerëzit e tjerë që punojnë në zonat rurale duhet të mbështeten në përpjekjet e tyre për të promovuar dhe ndërmarrë praktika të qëndrueshme të prodhimit bujqësor që mbështesin dhe janë në harmoni me natyrën, të referuara edhe si Toka Nënë në një numër të vendeve dhe rajoneve, duke përfshirë duke respektuar aftësinë biologjike dhe natyrore të ekosistemet për t'u përshtatur dhe rigjeneruar përmes proceseve dhe cikleve natyrore.

Duke pasur parasysh kushtet e rrezikshme dhe shfrytëzuese që ekzistojnë në shumë pjesë të botës në të cilën shumë fshatarë dhe njerëz të tjerë që punojnë në zonat rurale duhet të punojnë, shpesh u mohohet mundësia për të ushtruar të drejtat e tyre themelore në punë dhe mungesa e jetesës pagat dhe mbrojtja sociale,

Të shqetësuar se individët, grupet dhe institucionet që promovojnë dhe mbrojnë të drejtat e njeriut të atyre që punojnë në çështjet e tokës dhe burimeve natyrore përballen me një rrezik të lartë subjekt i formave të ndryshme të frikësimit dhe cenimit të integritetit të tyre fizik,

Duke vënë në dukje se fshatarët dhe njerëzit e tjerë që punojnë në zonat rurale shpesh përballen me vështirësi duke fituar akses në gjykatë, oficerë policie, prokurorë dhe avokatë në masën që ata janë në pamundësi për të kërkuar kompensim të menjëhershëm ose mbrojtje nga dhuna, abuzimi dhe shfrytëzimi,

Të shqetësuar për spekulimet për produktet ushqimore, përqendrimin në rritje dhe shpërndarja e pabalancuar e sistemeve ushqimore dhe marrëdhëniet e pabarabarta të fuqisë përgjatë vlerës zinxhirët, të cilët dëmtojnë gëzimin e të drejtave të njeriut,

Duke riafirmuar se e drejta për zhvillim është një e drejtë e patjetërsueshme e njeriut në bazë të së cilës çdo person njerëzor dhe të gjithë popujt kanë të drejtë të marrin pjesë, të kontribuojnë dhe gëzojnë zhvillim ekonomik, social, kulturor dhe politik, në të cilin të gjitha të drejtat e njeriut dhe liritë themelore mund të realizohen plotësisht.

(Vijon në numrin e ardhshëm)



Kredi Agrobiznes 

A mund të blej makineri dhe
pajisje të reja bujqësore?

*SIGURISHT,
BËHET!*



CREDINS bank

www.bankacredins.com

Tel.: +355 4 53 53 000

